



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Marrëdhënie Ndërkombëtare”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut në
Tiranë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Dr. Elda Zotaj

2. PhD. Gert Guri

Tetor /2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut Tiranë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i New York-ut Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.939, datë 03.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr.179, datë 10.09.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 89, datë 07.12.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020 – 2021 5 PAE 2021 – 2022 5 PAE 2022 – 2023 6 PAE
18	Numri i studentëve:	➤ 2022-2023 6 studentë ➤ 2021-2022 3 studentë ➤ 2020-2021 6 studentë ➤ 2019-2020 2 studentë ➤ 2018-2019 8 studentë




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)


Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Elda Zotaj ekspert vendas dhe drejtues i GVJ dhe PhD. Gert Guri ekspert i huaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Ersi Dako, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **26 dhe 27 Qershor 2023** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Më datë 18.10.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 118/60 Prot., datë 18.10.2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL, më datë 23.10.2023, përmes AMS dhe shkresë zyrtare Nr. 91/2 Prot., datë 19.10.2023 shprehet se do të marrë masat e nevojshme me synim përmbushjen e tyre. Për sa më lart, Draft-Raporti kthehet në Raport përfundimtar.



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Universiteti i NewYork është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi është licencuar fillimisht nëpërmjet VKM 939 datë 3.09.2009 dhe ka filluar veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011. Në vitin 2012 i është dhënë akreditimi i parë në përmbushje të legjislacionit në fuqi të kohës. Procesi i akreditimit periodik ka vijuar në 2018 dhe aktualisht programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik për herë të tretë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si edhe Departamenti i Psikologjisë. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë dhe të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze, 120 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me pedagogët e programit GVJ konstatoi se ka një kujdes të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë profesionale duke marrë pjesë në aktivitetet dhe botimet kërkimore ndërkombëtrae. Studentët e këtij programi studimi vlerësuan se ata mbështën shumë nga stafi akademik duke u përfshirë në punën kërkimore të pedagogëve, si edhe në aktivitetet të tjera shkencore sic janë organizimi i konferencave me tematika relevante për programin e studimit. Ofrimi i të gjithë programit të studimit në gjuhën angleze ofron më shumë mundësi bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin e datës 26.11.2018, datë janë:

1. Promovimi më efektiv i këtij programi për të kapërcyer limitet e tregut të punës.
2. Detyrimi për marrjen e titullit Profesor i Asociuar nga ana e Dekanit të Fakultetit.
3. Seminar për stafin akademik dhe studentët për të rritur ndërgjegjësimin për bashkëpunimin shkencor në nivel institucional.
4. Nje pjesmarrje më e madhe në programet Erasmus +.
5. Një vëmendje më e madhe në lëndët e formimit bazë përgjatë vitit të parë.
6. Të rritet numri i lëndëve të grupit A që studentët të përmirësojnë nivelin teorik.
7. Të rritet numri i moduleve me zgjedhje.
8. Lidhje më e ngushtë e kurrikulës me tregun e punës.
9. Të ulet numri i orëve të pedagogëve në mësimdhënie.
10. Të rriten mekanizmat në dispozicion të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë për të kontrolluar efektshmërinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për rekomandimin e parë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Konkretisht është caktuar në drejtor i programeve master në nivel institucional, i cili bashkëpunon me kordinatorët e programeve të studimit dhe me stakeholders të jashtëm për të harmonizuar programin e studimit me kërkesat e tregut të punës.

Për rekomandimin e dytë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Dekania e Fakultetit ka marrë titullin Profesor i Asociuar.

Për rekomandimin e tretë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Që nga viti 2019, UNYT ka institucionalizuar praktikën e Seminareve Akademike ku studentët bashkëpunojnë me pedagogët në punimet shkencore.

Për rekomandimin e katërt GVJ vlerëson se është *përbushur*. Është rritur ndjeshëm si numri i programeve Erasmus +, ku IAL merr pjesë si partner, ashtu edhe numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit si me universitetet e Granadës, Tilbur, Gjenovës, etj.


Për rekomandimin e pestë dhe të gjashtë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Rritja e lëndëve të formimit bazë teorik si Metodatat Kërkimore dhe Cilësore, Teoria dhe Praktikat e Marrëdhënies Ndërkombëtare, Transformimi i Sistemit Ndërkombëtar janë pjesë e programit ndërsa lëndë të tjera si Kultura Diplomatike, Promovimi Demokratik i BE-së ofrohen në vitin e parë të studimit.

Për rekomandimin e shtatë GVJ vlerëson se është *përmbushur*. Është rritur numri i lëndëve me zgjedhje në programin e studim, sic është: “EU Democracy Promotion: Theory and Practice” apo “Ethnicity and Nationalism”.

Për rekomandimin e tetë GVJ vlerëson se është *përmbushur*. Takimet periodike me aktorë të rëndësishëm institucionalë në tregun e punës, integrimi i përfaqësuesve të këtyre institucioneve në aktivitetet shkencore, si edhe organizimi i përvitshëm i panairëve të tregut të punës kanë mundësuar një lidhje më të mirë me tregun e punës, cka dëshmohet edhe nga punësimi 100% i studentëve të këtij programi.

Për rekomandimin e nëntë GVJ vlerëson se është *përmbushur*. Tashmë stafi i brendshëm akademik është plotësuar si në numër ashtu edhe në tematika dhe me nivelin e titujve akademikë, cka ka kontribuar në uljen e numrit të orëve nga pedagogët. Shpërndarja e punës konsideron specializimin dhe ngarkesën akademike apo institucionale të cdo pedagogu. Kjo u dëshmua edhe nga pedagogët e programit në takimet me GVJ.


Për rekomandimin e dhjetë GVJ vlerëson se është *përmbushur*. Mekanizmat e kontrollit të sigurimit të cilësisë janë rritur duke filluar nga marrja periodike e opinionit të studentëve për pedagogët, vetëvlerësimi i pedagogëve, vlerësimi P2P, cka kontribuojnë në përgatitjen e seminareve periodike për trainimin e stafit akademik.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në dokumentat strategjike të Universitetit të Neë York-ut, në Tiranë (UNYT), i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, theksohet rëndësia e këtij institucioni në raport me interesat kombëtare si dhe qasjen ndaj zhvillimit të shumë-anshëm të vendit. Misioni i institucionit (neni 3) është krijimi, zhvillimi, përcjellja, dhe mbrojtja e dijeve, si dhe përgatitja e qytetarëve paraprirës të së ardhmes, profesionistëve dhe akademikëve të ardhshëm me anë të mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritimit në komunitet, si dhe duke siguruar njohuritë, aftësitë, karakterin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar. <i>(Evidenca Nr. 1.1 Statuti, Alb fq.3)</i> Një program i tillë që synon përgatitjen e profesionistëve në Marrëdhënie Ndërkombëtare ka një rol të rëndësishëm në arritjet e interesave kombëtare të vendit për integrim në BE, në kontributin e saj në NATO etj. Informacioni i paraqitur nga institucioni shpjegon se si vlerat akademike dhe kulturore të vendit promovohen dhe ruhen nëpërmjet edukimit me standarte të larta të studentëve dhe partneriteteve me institucione të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>(Evidenca Nr. 1.6 Strategic Plan, Alb; Evidenca Nr. 1.10 Rregullore e programit- MA ne Marredhenie Nderkombetare)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Qëllimet dhe objektivat e programit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” shprehen qartë për formimin akademik të studentëve bazuar në njohuritë bashkëkohore dhe praktikat e mira në fushë, por edhe në përputhje me kontekstin e zhvillimit të vendit dhe më gjërë. <i>(Evidenca Nr.1.10 Rregullore e programit- MA ne Marrëdhënie Ndërkombëtare. Fq.11)</i> Ka një përputhje shumë të mirë të programit të studimit me misionin dhe qëllimin e institucionit duke marrë parasysh karakteristikat e programit. Institucioni ofron programe studimi të afërta me këtë program studimi. Masteri i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare u ofron studentëve një mundësi unike për të marrë një nismë studimore e cila bashkëvendos teorinë e marrëdhënies



	ndërkombëtare përkrah përvijës konkrete të punës në këtë fushë, me aktorët vendas, rajonal dhe me bashkësinë ndërkombëtare në përgjithësi. (Evidenca Leter nga Dekani IR)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Në Statutin e UNYT (miratuar në korrik 2020) neni 1 thuhet se: “UNYT ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të cilat janë miratuar nëpërmjetë akteve ligjore respektive” po kështu nenet 9; 10; 11; 12 përcaktojnë strukturën organizative të universitetit (Evidenca Nr.1.1 Statute, Alb fq.6-8). Gjithashtu në Rregulloren Akademike të Institucionit (miratuar më 28.10.2022), e cila është dokumenti themelor i veprimtarisë konkrete institucionale përcaktohen, strukturat, objektivat, parimet dhe shtyllat e aktiviteteve kryesore të UNYT. Këto dy dokumente themelore sëbashku me Planin Strategjik 2020-2025 japin drejtimet prioritare akademike dhe demostrojnë qartë se programet e studimit hartohen në zbatim të tyre (Evidenca Nr. 1.7 UNYT Rules and Regulation; Evidenca Nr. 1.6 Strategic Plan, Alb). Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimet akademik dhe të kërkim zhvillimit të UNYT. Në hartimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimi për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky program është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së Universitetit të Neë York-ut, në Tiranë (UNYT) për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj. Fusha e studimeve të thelluara në Marrëdhënie Ndërkombëtare ka rëndësi të lartë pasi ndërlihd dijet politike dhe zhvillimeve në kontekstin, kombëtar, rajonal dhe global duke aftësuar profesionistë në këtë drejtim për të mundësuar zhvillimin e shoqërisë në këtë dimension. Edhe fushat e kërkimit shkencor të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore për vitet 2018-2022 dhe në dokumentin e rishikuar për vitet 2023-2027 mbeten të njëjtat dhe lidhen thellësisht me fushën e këtij programi studimi. (Evidenca Nr. 2.12 UNYT Research Pillars; Evidenca Nr.2.13 UNYT Research Pillars 2023 -2027)
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Shqyrtimi i dokumentave të programit dhe institucionit në tërësi, por edhe të dhënat nga takimet me drejtues të institucionit, stafin akademik dhe studentët dëshmojnë synimet dhe përpjekjet për të ofruar një program me qasje të bazuar në përputhje me interesin kombëtar si dhe dhe prirjet globale të zhvillimit politik dhe ekonomik. Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është hartuar dhe synon të mbështet e të nxisë nevojat e zhvillimit politik, social dhe ekonomik të vendit. Kurrikula e këtij programi studimi është

	hartuar duke u bazuar në dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombetare dhe i shërben formimit të profesionisteve në të gjitha nivelet (<i>Evidenca Nr. 1.5 CurriculaSchedule; Evidenca RVB IR Shqip</i>). Programi synon të furnizojë tregun me specialist njohës të politikës dhe zhvillimeve ndërkombëtare duke i shërbyer rritjes së performancës së institucioneve të shtetit dhe organizmave ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë si dhe zhvillimit ekonomik dhe social në tërësi.			
Konkluzione	<i>Bazuar në sa më lart, institucioni i arsimit të lartë, që ofron programin e studimit Master Shkencor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare", përmbushur plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe zhvillimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti dhe njësia bazë në të cilën bën pjesë program i studimit disponon burimet e nevojshme njerëzore, të cilët janë të përfshirë në mësimdhënien e këtij programi studimit. Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni rezulton se për vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare në përbërje të tij ka 8 anëtar të stafit akademik me kohë të plotë. Stafit akademik është i pajisur me tituj dhe grada si vijon: 3 anëtar janë të kategorisë profesor (1 Prof. dr dhe 2 Prof. Asoc), 4 anëtar me gradën Dr/PhD dhe 1 me Msc. Bazuar në CV e stafit akademik dhe shtyllat kryesore të kërkimit shkencor, rezulton se Departamenti është i përbërë nga anëtarë me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale. Gjithashtu gjatë vitit akademik 2022-2023 janë angazhuar dhe 2 lektorë me kohë të pjesshme me gradën Dr. (<i>Evidenca Nr. 2.14 UNYT Lista e Personelit Akademik; Evidenca Nr. 3.8 UNYT Academic Staff CV; Evidenca Nr. 2.12 UNYT Research Pillars</i>). Institucioni dëshmon se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore është një nga tre njësitë

<p>dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>kryesore të UNYT dhe ka në përbërje të tij tre departamente: Departamenti i Drejtësisë; Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Departamenti i Psikologjisë (<i>Evidenca Nr.1.1 Statute, Alb fq.6</i>) Programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në tërësinë e tij, programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Ky program studimi është në nivelin 7 në kornizën kombëtare të kualifikimeve. Fusha e përgjithshme e programit të studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi. (<i>Evidenca Nr. 2.14 UNYT Lista e Personelit Akademik; Evidenca Nr. 3.8 UNYT Academic Staff CV</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Masteri Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet bazuar në Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe akteve rregullatore të UNYT. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2022-2023 ka pasur në përbërje të tij tetë anëtarë personel akademik me kohë të plotë, 3 prej të cilëve janë të kategorisë Profesor (1 Prof Dr dhe 2 Prof Asoc), 4 me gradë shkencore Doktor dhe të 1 me MSc. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, ky program ka 120 ECTS, përgjatë dy viteve akademike dhe është i shtrirë në katër semestere ku dy komponentët e fundit i dedikohen studentit që shkruan një tezë nën supervizionin e profesorit dhe zhvillon praktikën profesionale. Programi zhvillon një kuptim sistematik të thelluar të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe siguron aftësitë e nevojshme për të analizuar dhe vlerësuar problemet komplekse politike në nivel rajonal e global, aspekte ekonomike dhe çështjet e ndërlydhura. (<i>Evidenca Nr.1.10 Rregullore e programit- MA ne Marrredhenie Nderkombetare</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm (<i>Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm (<i>Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, bazuar në analizën e standartit I.2 programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni në dokumentet strategjike të tij si Statut, Rregullore etj (të bazuara në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tjera nënligjore), ka të përcaktuar qartë strukturat institucionale me karakter akademik dhe administrativ për realizimin e aktivitetëve në përputhje me qëllimet e tij. Institucioni sigurohet që programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” të realizohet nga një staf burimesh njerëzore të kualifikuar si në drejtimin akademik dhe në atë administrativ apo institucional. Krahas rregullores së institucionit, njësia kryesore dhe ajo bazë kanë rregulloret përkatëse. Në rregulloren e Fakultetit, dhe atë të njësisë bazë, janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion (<i>Evidenca Nr.1.8 Faculty Rules and Regulation, Alb; Evidenca Nr.1.9 Rregullore Departamenti, Eng</i>). Departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kontrate (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte shumë të mira me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Njësi të tjera si Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KoGaSC) dhe më konkretisht Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NjSC) realizojnë vlerësime periodike të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore (<i>Evidenca Nr.1.7 UNYT Rules and Regulation (neni 29; 30), fq. 22-23</i>). Gjithashtu njësi të tjera si: sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit në zyrat e ndryshme, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Çdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit përkatës.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda</p>	<p>UNYT ka dy dokumente të rëndësishme që lidhen me vizionin e bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizimit të tij si: Plani Strategjik 2020-2025 dhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2020-2025 (<i>Evidenca Nr. 1.6 Strategic Plan, Alb; Evidenca Nr. 1.16 Internationalization Strategy 2020 Alb</i>). UNYT e sheh ndërkombëtarizimin si një përbërës kryesor të</p>

<p>dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>zhvillimit dhe misionit të tij të përgjithshëm strategjik. Me Vendimin e Senatit Nr. 22 / 29.09.2016 u krijua Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO). Në dokumentin Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2020-2025 thuhet se: “Universiteti synon të krijojë dhe ruajë njohjen kombëtare dhe rajonale, si një nga institucionet më kryesore të arsimit të lartë në Shqipëri dhe rajon. UNYT kërkon në mënyrë aktive të bashkëpunojë me institucionet më të mira arsimore të BE dhe jashtë BE me qëllim krijimin e një kurrikule të njohur ndërkombëtarisht dhe të mësojë nga praktikat më të mira të universiteteve udhëheqëse” (Evidenca Nr. 1.16 Internationalization Strategy 2020 Alb, fq.4). Strategjia e ndërkombëtarizimit ka si objektivi të saj krijimin e partneriteteve ndërkombëtare. Në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit. Këto marrëveshje janë lidhur për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, për zhvillimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, bashkëpunim me aktorët e biznesit dhe më gjërë (Evidenca Nr.5.1 UNYT List of MoU-s).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme (Evidenca Nr.5.1 UNYT List of MoU-s). <i>Theksojmë se në planin mësues nuk parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale.</i> Më konkretisht tek seksioni “Lëndë Politësuese –D” ku parashikohet praktika profesionale në kurrikulën e këtij masteri ky seksion ka një lëndë “European History and Civilization” (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese, Tabela nr 9, fq 9-10). <i>GVJ sygjeron që institucioni të realizojë ndryshime në kurrikulën ku të përfshihet “Praktika Profesionale”.</i> Kjo është një domosdoshmëri për ti mundësuar studentit lidhjen me tregun e punës përmes kontaktit që vendoset nga zhvillimi i praktikës profesionale. Vlen të theksohet si element pozitiv i kurrikulës fakti që në seksionin “Detyrime Përmblyëse” krahas realizimit të tezës e cila ka 40 kredite, është përfshirë dhe komponenti “Graduate Conference” me 2 kredite. Realizimi i këtij komponenti stimulon edhe më tej kërkimin shkencor tek studentët e këtij masteri. Duhet theksuar se në focus të institucionit është rritja e bashkëpunimit me institucione partnere dhe jo vetëm. Në Planin Strategjik 2020-2025 një nga qëllimet e tij është ofrimi i një “Mjedisi Arsimor Ndërkombëtar” përmes realizimit të objektivave si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të universiteteve që janë vende partnere në kuadër të Programit Erasmus + (K107). • Rritja e numrit të marrëveshjeve bilaterale (MoU) me universitetet që inkurajojnë mundësinë e mobiliteteve të studentëve dhe stafit. (Evidenca Nr. 1.16 Internationalization Strategy 2020 Alb, fq.4-5)
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Në RVB thuhet se “Njësia bazë përgjegjëse...harton në mënyrë të rregullt raporte vlerësuese dhe faktike mbi të dhënat e viteve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 12




përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	akademike...” (Evidenca RVB IR Shqip, fq.14) dhe si dokument orientues jepet Evidenca Nr.5.32. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti i titulluar “Dokumenti i Performancës” vërehet se raporti analitik është në nivel institucional dhe jo njësie bazë (Evidenca 5.32 UNYT Performance Document). GVJ sygjeron që njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi të hartoj në vijim raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimin në institucion GVJ konkludon se njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtare dhe kombëtarë për realizimin sa më efektiv të këtij programi. Megjithatë, duhet të lihet në vëmendje të institucionit se në kurrikulën e këtij program Master Shkencor duhet të përfshihet “Praktika Profesionale” për të bërë me efektive marrëveshjet e bashkëpunimit përmes realizimit konkret dhe të detyruar të praktikës për programin në fjalë. Gjithashtu positive do të ishte nëse njësia bazë do të realizojë në vijim raporte analitike mbi të përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në	Programi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i organizuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Kreditit (ECTS) në total 120 ECTS. Programi ofrohet në kurse të ndara dy vite akademike bazuar në plotësimin e nevojave të studentëve që ndjekin

<p>përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>këtë program dhe natyrës së lëndëve. Për shembull, lëndët me natyrë formuese teorike si “marrëdhënie ndërkombëtare, Teoria dhe Praktika” dhe lëndët si ‘Metoda Cilësore dhe Sasiore të Kërkimit’, Politika Krahasuese” apo “Transformimi i Sistemit ndërkombëtar” ofrohen përgjatë semestrit të I-rë në vitin e parë të studimit. Gjatë vitit të parë akademik student realizon 9 lëndë gjithsej, 4 në semestrin e I-rë dhe 5 në semestrin e dytë. Gjatë vitit të dytë akademik student realizon 4 lëndë në semestrin e parë dhe përgjatë semestrit të dytë të realizon “Graduate conference” dhe “Msc Thesis” (<i>Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese, Tabela nr 9, fq 9-10</i>). Kategorizimi i lëndëve fillon nga lëndët bazë në ato të specializimit bëhet duke marrë parasysh njohuritë që kompletojnë formimin e studentit. 1 ECTS përmban 25 orë gjithsej në auditor (leksione & seminare) dhe punë individuale në formën e projekteve, detyrave të kursit, etj. Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të parashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ky program studimi, Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” përbën një përpjekje për të aftësuar studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative. Programi i studimit synon, nëpërmjet secilës lëndë, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional që kombinon teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare si në aspektin teorik dhe atë praktikë me modelet më të mira të analizave krahasuese dhe njohjen e organizatave ndërkombëtare etj (<i>Evidenca Nr.1.5 CurriculaSchedule</i>). Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënës dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde (<i>Evidenca Nr. 2.2 UNYT Syllabi</i>). Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentët për t’u përballur me specializimeve profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sikundër është konstatuar dhe më lartë, në kurrikulën e këtij program studimi nuk ka të parashikuar realizimin e “Praktikës profesionale”. Kreditet e përcaktuara në seksionin “Lëndë plotësuese” kategoria D, janë për realizimin e lëndës “European history and Civilization”. GVJ sygjeron që kurrikula të rishikohet dhe të ndryshohet ky komponent duke përfshirë praktikën profesionale. Përsa i takon detyrimeve përmbyllëse, në programin mësimor është parashikuar që përmbyllja e studimeve të realizohet me temë diploma, e cila ka 40 ECTS.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi</p>

Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Mbështetur mbi kriteret e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015, institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat mbi pranimin, transferimin dhe përzgjedhjen e studentëve në aktet e brendshme të tij (<i>neni 66 i Statutit, fq. 40</i>). Senati akademik realizon vendimmarrje të përvitëshme në lidhje me kriteret e pranimit të UNYT (Vendimi nr.70; dt 29.01.2021; Vendimi nr.78; dt 9.01.2022; Vendimi nr.89; dt 27.01.2023), dhe për programet e ciklit të dytë kriter është nota mesatare mbi 6.5 (<i>Evidenca Nr. 5.10 UNYT Senate Decision on Admission Criteria 2022-2023; Evidenca Nr. 5.10.1 UNYT Senate Decision on Admission Criteria 2023-2024; Evidenca Nr. 5.10.2 UNYT Senate Decision on Admission Criteria 2024-2025</i>). Në nenin 65 “Komisioni i pranimeve dhe transferimeve” të Statutit të UNYT parashikohen modalitetet e njësisë bazë në lidhje me këtë proces. Më konkretisht “Komisioni i pranimeve dhe transferimeve vepron në nivel department në lidhje me përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimit të kriterëve të pranimit...etj). Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit: https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/application-process/ e aksesueshme nga cilido i interesuar. Pranimi i studentëve që ndjekin programin master është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UNYT, Rregullat dhe udhëzimet respektive.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në RVB, Masteri i shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” e plotëson këtë kriter. (<i>Evidenca RVB IR Shqip, fq.18</i>)
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas	Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve të studimit, dhe për këtë proces ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe

fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sportit përmes shkresës me Prof. nr. 55 datë 29.03.2023 (<i>Evidenca Nr.1.3 Program Coding Prot. No. 55</i>). Kodifikimin kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Programi i studimit Masteri i shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” në tërësinë e tij, është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Universiteti i New York-ut Tiranë, ofron programe në bashkëpunim me State University of New York/Empire State College në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përsa i takon këtij program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër. Përsa i përket këtij kriteri nuk është i aplikueshëm për Masterin i shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”.			
Konkluzione	<i>GVJ thekson se shkalla e përmbushjes së standartit është e përmbushur plotësisht. Do të sugjerohej që institucioni në vijim të konsiderojë që në kurrikulën e këtij program studimi të përfshijë realizimin e “Praktikës profesionale”. Kreditet e përcaktuara në seksionin “Lëndë plotësuese” kategoria D, ti dedikohen edhe përfshirjes së praktikës. GVJ sygjeron që kurrikula të rishikohet dhe të ndryshohet ky komponent duke përfshirë praktikën profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Veprimtaria e fakultetit dhe departamentit mbështetet në aktet rregullatore të UNYT dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e parashikuara në këto akte. Për organizimin e punës krahas akteve në nivel institucional si rregullore Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, departamenti ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar për programin e studimit bachelor “Shkenca Politike” (<i>Evidenca Nr.1.10 Rregullore e programit- MA ne Marredhenie Nderkombetare</i>). Në këtë dokument janë të përcaktuara detajet dhe specifikimet e programit, qëllimet dhe objektivat e tij, mënyra e organizimit të studimeve, plani mësimor etj. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi



	(neni 4 dhe 5 i rregullores së departamentit përcakton funksionin dhe detyrat e tij) (Evidenca Nr.1.9 Rregullore e Departamentit). Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën dhe stafet akademike. Stafit me kohë të plotë që është pjesë e departamentit është i pajisur me tituj dhe grada.			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Sikundër është trajtuar dhe më lartë programi Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” nuk ka në kurrikul të parashikuar realizimin e praktikës mësimore (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese). Institucioni i ofron studentëve të këtij masteri një udhërrëfyes për përgatitjen e punimit përfundimtar. Në cilësinë e udhëheqësit shkencor, Stafit akademik departamentit i asiston në këtë proces (Evidenca Nr. 1.34 UNYT MA in IR Master Thesis Guideline).			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në Rregulloren e Departamentit përkatësisht neni 3 pika C cilësohet se: “Programe specifike të departamentit drejtohen nga stafit akademik i tij nëpërmjet koordinatorit të programit i cili është një nga stafit i departamentit që merr detyra të përgjithshme për aktivitete të programit” (Evidenca Nr. 1.9 Rregullore e Departamentit, fq. 4). Në bazë të vendimit datë 12.04.2022 në pozicionin e Koordinatorit të programit është caktuar PhD Marjana Prifti Skenduli (Evidenca Nr. 1.2 Appointment of Prof. Prifti Skenduli - Director of Graduate Programs).			
Konkluzione	GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe	Pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit, takimeve gjatë vizitës në UNYT dhe dokumentave shtesë, grupi i ekspertëve të jashtëm thekson se Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare disponon informacionin dhe teknikalitetet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>përmbajtjen e programit të studimit, të cilat janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe punim diplome të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në dy vite akademik, të ndarë në dy semestre. (Evidenca Nr. 1.10 Rregullore e programit- MA ne Marrredhenie Nderkombetare).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ky program studimi është i organizuar në 2 vite akademike (4 semestra) me një total kreditesh 120 ECTS. Çdo vit akademi përmban 60 ECTS me nëndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Perbledhese). Gjuha e programit të studimit është Anglisht. Në rregulloren akademike të institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. (Evidenca Nr. 1.10 Rregullore e programit- MA ne Marrredhenie Nderkombetare)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka një kuadër të plotë rregullator që lidhet me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ato janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit UNYT (neni 68 i Rregullores së Universitetit) dhe të rregullores së programit të studimit ku përcaktohen modalitetet dhe strukturat përgjegjëse për këtë proces. (Evidenca Nr. 1.7 UNYT Rules and Regulation; Evidenca Nr. 1.9 Rregullore Departamenti, Eng). Në dokumentin “Rregullore e transferimit të krediteve” përcaktohen procedurat dhe dokumentacionet që nevojiten në raste të tilla (Evidenca Nr. 1.28 UNYT Transfer Credit Regulation, Eng). Në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, institucioni përmes zyrës së çështjeve studentore, sekretarisë mësimore etj apo faqes zyrtare krijon një sistem informacioni të aksesueshëm për studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit Masteri i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit</p>

(syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	të miratuara, në nivel institucioni. Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. (Evidenca Nr. 2.2 UNYT Syllabi; Evidenca Nr. 3.10 UNYT Syllabus Information)								
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Pasurimi i bibliotekës me libra të dedikuara lëndëve të këtij program studimi (vlen të përmendim tutuj të tillë si: Cases in Comparative Government and Politics (botim i vitit 2019); Introduction to International Relations: Perspectives, Connections and Enduring Questions, 3rd edition (botim i vitit 2022) etj) apo rishikimi periodik i syllabuseve janë disa nga elementët e përmirësimit të programit (Evidenca Nr. 4.1 UNYT Books Report).								
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë të studimit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” konstatohet se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe detyrimet përmblylëse, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmblylëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e fundit me detyrimet përmblylëse (Evidenca Nr. 1.9 Rregullore Departamenti, Eng: Evidenca



	<i>Nr. 2.1 Tabelat Permbledhese</i>). Të dhënat tregojnë për një punësim të plotë të studentëve që kanë realizuar studimet në këtë master, vit pas viti nga 2018 deri në vitin 2022 (<i>Evidenca Nr.5.20 UNYT Data on the Employment of Students</i>).
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Vlerësohet se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare, mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të dytë të përcaktuar në Rregulloren e tij. Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 4 semestra të shtrira përgjatë 2 viteve akademike, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimi të studentëve. (<i>Evidenca Nr. 2.1 Tabelat Permbledhese</i>)
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare është i mirë-strukturuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në harmoni të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli “master” si në nivelin kombëtar dhe atë rajonal për studentët brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, bën të mundur arritjen e objektivave formuese të studentit (<i>Evidenca Nr. 2.1 Tabelat Permbledhese</i>). Gjithashtu, programi mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve pasi programi i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimi për tregun e punës. Syllabuset e lëndëve në programin e studimit kanë rubrikën e kontrollit të dijeve të ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 2.2 UNYT Syllabi</i>). Krahas “Detyrimeve Përmbyllëse” që përkon me punimin përfundimtar, departamenti organizon dhe graduate conference për studentët që ndjekin këtë program.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të	GVJ konstaton se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxëniet, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i

punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. <i>Ajo që u konstatua është mungesa e një formati të unifikuar tek disa syllabuse. Pra elementët e sipërcituar janë në silabuse por nuk është formati i standartizuar tek të gjitha ato. Rekomandohet që të realizohet rishikimi dhe unifikimi tyre (Evidenca Nr. 2.2 UNYT Syllabi).</i> Në mënyrë periodike, institucioni u kërkon pedagogëve përditësimin e syllabuseve (Evidenca RVB IR Shqip). Referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj ka nevojë që në disa lëndë të azhurnohet aty ku është e mundur me literaturë të 5 viteve të fundit me profilin specifik lëndor.			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik). (Evidenca Nr. 2.1 Tabelat Permbledhese)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në kuadrin e përmbajtjes së përgjithshme të programit të studimit në fjalë, GVJ konstaton se vijueshmëria është e mundshme në realizimin e studimeve të ciklit të trete të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe me profesionet që lidhen me administratës publike, kërkues shkencor në institucione, organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare etj (Evidenca Nr.5.20 UNYT Data on the Employment of Students).			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxëniet, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve si dhe të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më	Institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimin



<p>mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>të përmbajtjes së programeve të studimit (<i>Evidenca Nr. 1.1 Statute, Alb; Evidenca Nr. 1.7 UNYT Rules and Regulation; Evidenca Nr. 1.9 Rregullore e Departamentit; Evidenca Nr. 1.6 Strategic Plan, Alb; Evidenca Nr.1.16 Internationalization Strategy 2020 Alb</i>). Departamenti si njësi përgjegjëse për nisjen e këtij procesi për realizimin e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës ndihmohet dhe nga strukturat përgjegjëse të cilat konsultohen me rezultatet dhe propozimet që nxirren nga raportet dhe analizat e realizuara në mënyrë të vazhdueshme nga struktura të caktuara (<i>Evidenca RVB IR Shqip; Evidenca Nr.3.16 UNYT Studim Tregu, Alb</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni realizon në mënyrë periodike vlerësimin e performancës së stafit akademik nga studentët. Ky proces i mundëson institucionit marrjen e informacionit nga studentët për mbarëvajtjen e programit të studimit në disa komponent të tij (<i>Evidenca Nr.6.9 UNYT Sample of Student Evaluation Form; Evidenca Nr.6.9.1 UNYT Student Evaluation Report; Evidenca Nr. 6.9.3 UNYT E-mail for Evaluation of Academics by Students (To each professor)</i>). Departamenti realizon një punë përfshirëse me studentët përmes takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me ta. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Gjatë takimit me studentët na u konfirmua përfshirja dhe komunikimi i afërt që ata kishin me stafin dhe drejtuesit e departamentit. Institucioni ndjek një politik mbështetëse dhe me bursa për studentët që dalin me rezultate shumë të larta.</p> <p>(<i>Evidenca Dokumentacioni shtesë; Mlmutat UNYT, fq.1-2 dhe 10</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare është një njësi bazë tejet e suksesshme përsa i takon realizimit dhe përfshirjes në projekte ndërkombëtare Jean Monnet duke shënuar 3 module, 1 Network dhe 1 Qendër Ekselence projekte të fituara në kuadër të këtij programi nga stafi i këtij departamenti (<i>Evidenca Nr.1.33 UNYT – A Jean Monnet Centre of Excellence! – University of New York Tirana</i>). Këto projekte kanë rezultuar iniciativa shumë të suksesshme dhe me impakt në lidhje me përmirësimin e programit të studimit si në mësimdhënie dhe në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>(<i>Evidenca Nr.2.12 UNYT Research Pillars</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së këtij standardi konkludon se institucioni ka një eksperiencë tejet pozitive në përthithjen e fondeve të huaja në formën e projekteve të BE-së si Jean Monnet (modul; qendër ekselence etj apo projekte të tjera duke ndikuar që ky program të përmirësohet edhe më tej.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Institucioni në të gjitha nivelet ka hartuar dokumenta strategjik ku përfshihen qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit (<i>Evidenca Nr.1.16 Internationalization Strategy 2020 Alb; Evidenca Nr.1.6 Strategic Plan, Alb; Evidenca Nr.2.13 UNYT Research Pillars 2023 -2027</i>). Ky program synon formimin dhe përgatitjen e studentëve në drejtime si: Diplomaci; shërbim civil; Organizata ndërkombëtare etj (<i>Evidenca RVB IR Shqip, fq.25</i>). Njësia bazë (departamenti) ushtron kompetenca në bazë të parashikimeve ligjore. Kjo njësi organizon dhe bashkërendon punën institucionale dhe akademike (<i>Evidenca Nr.1.9 Rregullore e Departamentit, fq.4</i>). Realizimi i këtij synimi kërkon gjithashtu dhe zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e shtyllave të kërkimit shkencor dhe rritjes së standardeve të performances akademike.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Institucioni ka të përcaktuar në nenin 6 të Statutit “Liria akademike dhe mundësitë e barabarta” themelin e garantimit të lirive akademike në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor, inovacion si dhe në veprimtaritë krijuese... etj”. Gjithashtu ky nen përcakton se “Veprimtaria universitare bazohet në merita akademike ndërsa përjashtohen diskriminimet në bazë të rracës, të ngjyrës të fesë...” (<i>Evidenca Nr.1.1 Statute, Alb</i>). Njësitë kryesore të institucionit ushtrojnë aktivitetin e tyre akademik bazuar në rregullat dhe politikat e përcaktuara në Rregulloren e njësisë kryesore dhe asaj bazë. Departamenti respekton lirinë akademike të personelit akademik në fushën e programit të studimit (<i>Evidenca Nr.1.8 Faculty Rules and Regulation, Alb; Evidenca Nr.1.9 Rregullore e Departamentit</i>).
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në takimin e realizuar me studentët e këtij program studimi na u pranua se institucioni i nxit, mbështet dhe angazhon në projekte, mobilitete apo në aktivitetet kërkimore, në kuadër të realizimit të studimeve (<i>Evidenca Dokumentacioni shtesë; MInutat UNYT, fq.10-11</i>). Gjithashtu realizimi i graduate conference apo realizimi i punimeve në kuadër të programeve të lëndëve që ata realizojnë në këtë program i orienton dhe përgatit në fushën e hulumtimit dhe kërkim shkencor (<i>Evidenca Nr.1.21 UNYT</i>

	<i>International Student Congress).</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni ka praktika serioze për realizimin sa më efektiv të programit të studimit dhe dhënies së mbështetjes financiare si për stafin akademik atë administrative dhe për studentët (<i>Evidenca Dokumentacioni shtesë; Minutat UNYT</i>). Institucioni ka një dokument të titulluar “Udhërrëfyesi i Promovimit Akademik” ku përcaktohen kriteret e promovimit si për stafin akademik dhe atë administrative. (<i>Evidenca Nr.1.27 UNYT Academic Promotion Guidelines</i>)			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat e realizuara në UNYT, GVJ konkludon se strukturat përgjegjëse si njësia kryesore dhe ajo bazë bëjnë të mundur realizimin e programit të studimit të lidhur me orientimin dhe fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi realizon objektivat e vendosura në dokumentet strategjike të zhvillimit institucional dhe kërkimi shkencor në përputhje me fushën e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Sipas RVB-së dhe konstatimeve gjatë vizitës, institucioni në tërësi dhe njësia bazë në veçanti e nxit dhe mbështet stafin në projektet kërkimore-shkencore egzistuese dhe siguron bashkëpunimin ndërmjet strukturave të institucionit për realizimin e objektivave të programit të studimit në zhvillimin e kërkimit shkencor. Nga shqyrtimi në tërësi i Rregullores së Departamentit dhe pjesa e saj ku përshkruhet departamenti (seksionin “Basic Provision” nga neni 1 deri tek neni 5) nuk ka të cilësuar në asnjë nen të saj krijimin e “Grupet kërkimore”. Sugjerohet që një nismë e tillë e krijimit të grupeve kërkimore të ndërmerret nga institucioni në vijim (<i>Evidenca Nr.1.9 Rregullore e Departamentit</i>).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Stafi i Departamentit të Shkencave Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare është i përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në studime e projekte me karakter kërkimor-shkencor. Duhet theksuar se stafi i kualifikuar i departamentit që është aktiv në shkrim projektsh dhe punë kërkimore si dhe natyra që ka ky program studimi krijon mundësi për angazhimin e studentëve në projekte apo studime të ndryshme (<i>Evidenca Nr.3.8 UNYT Academic Staff CV</i>).

Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti organizon një sërë aktivitete me karakter studimor, e kërkimor shkencor të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët në arritjen e objektivave të programit të studimit (<i>Evidenca RVB IR Shqip</i>). Gjithashtu një element pozitiv është organizimi i Graduate Conference në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të programi mësimor (<i>Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese</i>).			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Kurrikula dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i rëndësishëm për vendin në proceset zhvillimore të tij. Ky program studimi formon profesionistë konkurrues për tregun e punës. Vlen të përmëndim faktin se të gjithë studentët e diplomuar janë të punësuar në përputhje me diplomën e fituar. (<i>Evidenca Nr.5.32 UNYT Performance Document</i>)			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<i>Ky kriter nuk është i aplikueshëm.</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<i>Ky kriter nuk është i aplikueshëm.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe vizitat ne Institucion, GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Si pjesë e Departmentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare (DSHPMN) programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive (<i>Evidenca Nr. 1.7, Rregullorja e Fakultetit neni 65 dhe 66</i>). Kështu leksionet gërshetohen me diskutim aktiv, punë në projekte si individuale ashtu edhe në grupe por edhe zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve (<i>Evidenca Nr. 1.25, Politikat dhe Procedurat e Zhvillimit të Kurrikulave</i>). Kjo arrihet duke zhvilluar analiza mbi papers, ese apo artikuj të marra nga literatura shkencore. Për të siguruar një rezultat sa më të lartë në mësimnxënie pedagogët ofrojnë një larmi metodash sic janë projektet në grupe, prezantimet individuale apo edhe përgatitje e videove prezantuese (<i>Evidenca Nr. 3.1, Instructors Handbook</i>). Këto forma janë mbështetur edhe me infrastrukturën përkatëse në nivel insitucional pasi UNYT ishte i pari IAL, i cili arriti të vinte në funksionim platformën online gjatë pandemisë, ndërsa vazhdon ta shfrytëzojë infrastrukturën e krijuar për të diversifikuar format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por edhe për administrimin e të dhënave të programit online (<i>Evidenca Nr. 3.13, Learning Platform</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Pjesa më e madhe e personelit akademik vjen nga një eksperiencë ndërkombëtare punësimi apo shkollimi, cfare i lejon programit që jo vetëm të vërë në zbatim forma bashkëkohore të mësimdhënies, por edhe të ofrojë mundësi të hapura me pedagogë të ftuar nga institucione ndërkombëtare (<i>Evidenca Nr. 2.7, Guest Speakers and Academic Seminars</i>). Një aspekt tjetër janë format e mësimdhënies si vizitat në terren, role-play për të ofruar mundësi njohjeje me realitetin përtej auditorit, të cilat harmonizohen edhe me aktivitete laboratorike sic janë praktikat e softëear statistikor (<i>Evidenca Nr. 2.8, UNYT MKT Activities</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>IAL edhe departamenti përkatës mbështetin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimujve për përmirësimin profesional. Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku</p>

	pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) botimi i monografive apo artikujve shkencore; c) programet e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare dhe vecanerisht ne Erasmus Mundus (<i>Evidenca Nr. 2.12, Research Pillars; Evidenca Nr. 5.2, UNYT and Mevlana Mobilities</i>).
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Diplomimi i pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi në universitet jashtë vendit, por edhe falë eksperiencës ndërkombëtare në mësimdhënie që ka një pjesë e tyre, natyrisht që ndihmon jo vetëm cilësinë profesionale të tyre, por edhe lejon programin që të përfitojë nga metodat bashkëkohore të mësimdhënies që ata sjellin (<i>Evidenca Nr. 3.8, UNYT Academic Staff CV</i>). Network që këta pedagogë sjellin nga këto eksperiencia ndërkombëtare favorizon edhe bashkëpunimin e mëtejshëm si në kuadër të programeve specifike si p.sh. Erasmus, por edhe në vendosjen e marrëdhënieve bilaterale të bashkëpunimit me institucione akademike evropiane sic janë Universiteti i Gena, Universiteti i Tilburg, ai i Renees, etj (<i>Evidenca Nr. 5.2, UNYT and Mevlana Mobilities</i>).</p> <p>Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i njohur nivelin e pjekurisë akademike si studentë masteri duke organizuar aktivitete shkencore me ta (<i>Takim me Stafin Akademik</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>DSHPMN përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimdhënies nga instanca të ndryshme të cilat mund të përmblihen në vlerësimin nga:</p> <p>a) Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për organizimin e punës didaktike dhe zhillimin strategjik të departamentit. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, kontrollit të cilësisë së syllabuseve, harmonizimit të ngarkesës së stafit akademik, ndihmës që i ofrohet stafit të ri, trainimit për përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimi të performancës së stafit akademik, etj (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and Regulations neni 21, 65, 66; Evidenca Nr.1.9, Rregullore e Departamentit neni 5</i>);</p> <p>b) Vlerësimi nga kolegët është një tjetër formë e cila synon dhënien e sugjerimeve për përmirësimin e cilësisë. Për këtë qëllim ekziston një pyetësor i vecantë, i cili plotësohet duke analizuar përshtypjet nga pjesëmarrja në leksionet e pedagogut që vlerësohet. Kjo praktikë është vecanerisht ndihmuese për pedagogët e rinj. Në këtë mënyrë, ky vlerësim jo vetëm që vë në dukje aspektet që kanë nevojë për përmirësim, por ofron edhe sugjerime konkrete se si mund të përmirësohen më tej këto dobësi. Raportet e vlerësimi të përgatitura nga kolegët por edhe raporti i transparencës së notave janë pjesë e raportit vjetor dhe i vihen në dispozicion pedagogëve përkatës (<i>Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook</i>).</p>


<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>IAL ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca Nr. 6.3, UNYT Regulation for the Internal Quality Assurance Unit</i>).</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmash si: 1) Vlerësimet periodike të studentëve për lëndën (<i>Evidenca Nr. 6.9, Sample of Student Evaluation</i>); 2) Raporti i vlerësimit që pedagogët bëjnë për njëri tjetrin (<i>Evidenca Nr. 6.4, Peer Evaluation Form</i>); 3) Raporti i vlerësimit të transparencës, paanësisë dhe krahasueshmërisë, nëpërmjet të cilit departamenti knotrollon nëse vlerësimi përfundimtar i studentit është kryer në bazë të kriterëve të paraqitura në plan-programin e hartuar nga pedagogu i lëndës (<i>Evidenca Nr. 1.19, UNYT Annual Report 2022: Department of Political Sciences-IR</i>); 4) Raporti i vetëvlerësimit të performancës, që kryen cdo pedagog duke analizuar arritjen e objektivave të vendosura në fillim të vitit akademik, dhe duke përcaktuar objektivat për vitin në vijim (<i>Evidenca Nr. 1.20, Individual Performance Assessment Form</i>); 5) Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, të cilat kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari në formë anonime. Ky vlerësim kryhet në baze të një lënde të një kursi dhe administrohet cdo semester. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYUT Rules and Regulations neni 29 dhe 30; Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook</i>).</p> <p>Vlerësimet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe me pas Rektoratit (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYUT Rules and Regulations neni 29 dhe 30</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni harmonizon një sërë formash të mësimdhënies dhe mësimxënies falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për evidentimin dhe zbatimin e formave sa më të mira të përmirësimit të punës së pedagogëve. Këta të fundit përballen me disa forma vlerësimi, si nga studentët, kolegët apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimxënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve pasqyrohet në syllabuset e cdo lënde, ku në një seksion të vecantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën. Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës. Në përgjithësi lëndët vlerësohen sipas shpërndarjes së mëposhtme: a) paper përfundimtar 50%; b) detyrë kursi ose prezantim 30%; c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës 20% (<i>Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit</i>). Kriteri i fundit i shërben pedagogut për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme progresin e studentit, si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe detyrave të kursit në klasë (<i>Takim me Stafin Akademik</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit. Këtu përfshihen edhe informacionet lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa me objektiv (<i>Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit neni 14</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim. Në këtë program mënyrat më të frekuentuara të kontrollit të mësim-nxënies janë kryesisht punimet shkencore si ese, detyrat e kursit, të cilat konsistojnë në prezantime individuale apo në grup, analiza artikujsh shkencore për të zhvilluar mendimin kritik (<i>Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook</i>). Duke patur parasysh nivelin master, ku kërkohet një reflektim mbi njohuritë e përfituara në përgjithësi nuk përdoren provimet por mini-ese, pyetje që kërkojnë zhvillimin e analizave, etj. Studentët kanë mundësi të njihen në detaje me kërkesat e formave të vlerësimit të përdorura dhe të bëjnë pyetje sqaruese në rast se është e nevojshme (<i>Evidenca Nr. 3.11, UNYT Final Exam Communication</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshetuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Një praktikë e mirë është edhe garantimi i pikëve shtesë për studentët që kryejnë punë kërkimore apo marrin</i></p>



	<i>pjesë në aktivitete shkencore. Zbatimi procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen si nga stafi akademik ashtu edhe ai ndihmës sic është stafi i IT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e departamentit përcakton parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave. Pamvarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, testimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndryshëm sic janë pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve. Kjo shihet në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra dhe peshën e vlerësimit që ka secili komponent, përcaktuar qartë në rregulloren e departamentit duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës a) paper përfundimtar 50%; b) detyrë kursi (që mund të jetë edhe një prezantim) 30%; c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës 20% (<i>Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit</i>).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UNYT ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit që përfshijnë: a) Tabelat e vlerësimit dhe ekuivalencës së notave (e përfshirë në Rregulloren e Departamentit dhe në syllabuset e lëndëve); b) Tabelat në Excel me kategoritë në përqindje për cdo komponent të vlerësimit; c) Sistemi Turnitin që përdoret për të shmangur plagjaturën (<i>Evidenca Nr. 2.4, Examination Procedures</i>). Të gjitha papers, ese apo të tjera punime të studentëve kalojnë nëpërmjet këtij sistemi dhe niveli i plagjaturës nuk duhet të kalojë 20%. Kjo i mundëson pedagogëve që jo vetëm të evidentojnë rastet e plagjaturës, por edhe të bëjnë sugjerimet përkatëse për studentët (<i>Evidenca Nr. 1.22, UNYT Sample of Turnitin Report</i>).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabusve përkatës për cdo lëndë dhe duke marrë parasysh përqindjet në vlerësimin përfundimtar të secilit element të testimit të lëndës sic u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për cdo element vendosen në një rubrikë të vecantë të syllabus, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të cdo lënde

	<i>(Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit neni 14, 23, 28, 29). Një kopje e syllabusit i dërgohet me email cdo studenti (Evidenca Nr. 3.10, Syllabus Information).</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi të studentit i bashkëngjitet feedback i pedagogut i përcjellë përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin <i>(Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook)</i> . Studentët motivohen që të kontribuojnë nëpërmjet P2P një mundësi jo vetëm për të pasuruar feedback e ofruar nga pedagogu por edhe për të zhvilluar më tej aftësitë e vlerësimit kritik nga ana e studentëve <i>(Takim me Studentët e Programit)</i> .
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Sistemit Turnitin kundër plagjaturës i nënshtrohen të gjithë punimet e studentëve. Plagjatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët si gjatë kursit ashtu edhe nëpërmjet Manualit të Instrukturëve, në mënyrë që studentët të informohen si duhet ta shmangin plagjiaturën, çfarë përbën plagjiaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore <i>(Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and Regulations)</i> . Përveç kësaj, në UNYT ekziston Kodi i Nderit, të cilit duhet të përmbahet cdo student duke u përpjekur që të mos bëjë asnjë veprim që bie ndesh me etiken akademike sic janë plagjatura apo kopjet në provime <i>(Evidenca Nr. 3.7, UNYT Student Honor Code)</i> . Përveç kësaj pedagogët sigurojnë që proceura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkelin etikën akademike <i>(Evidenca Nr. 2.4, Examination Protocol)</i> . Së bashku me specialistin IT krijohet dritarja përkatëse ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara <i>(Takim me Stafin Akademik)</i> .
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sic u përmend edhe më lart ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive personale të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndvështrim kritik. Në këtë mënyrë dhe me anë të një testimi të vazhdueshëm të njohurive, vlerësimi me notë i studentit pasqyron kompetencën e studentit në zotërimin e lëndës <i>(Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook)</i> . Rregullorja përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mesimore, pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik <i>(Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit neni 23)</i> . Ky informacion pasqyrohet në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e IAL. Kalendarin siguron një zbatim në kohë të të gjitha proceseve të vlerësimit si nota, dhënia e feedback, kontrolli i notave, si edhe kohën procedurale për ankimimin




	e notës (Evidenca Nr. 1.9 neni 23, Rregullore e Departamentit).			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsytim lidhur me vlerësimin me notë. Në rast se studenti për arsye objektive nuk ka arritur të japë maksimumin gjatë vlerësimit, atëherë mund të kërkojë nga pedagogu përsëritjen e provimit apo të detyrës për të cilën është vlerësuar (Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook).			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe më pas me këshilltarin akademik përkatës dhe në fund me Drejtorin e Departamentit. Procedurat e ankimit sanksionohen në rregulloren e departamentit si edhe në Manualin e Instrukturëve. Nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë studenti ka të drejtë të drejtohet Zyrës së Cështjeve Studentore dhe Peticioneve, të cilat ja përcjellin brenda 48 orëve Drejtorit të Departamentit. Ky i kërkon pedagogut që të bëjë rivlerësimin dhe në rast se studenti përsëri nuk është i kënaqur atëherë ngrihet një komision ad-hoc, vendimi i të cilit është definitiv (Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook).			
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Profili akademik i pedagogëve, të cilët janë doktoruar jashtë vendit por edhe puna kërkimore në vazhdim, si edhe bashkëpunimi në nivel akademik me homologët krijojnë mundësi që këto njohuri të mund të pasqyrohen edhe në lëndët përkatëse dhe në programin didaktik që vihet në dispozicion të studentëve. Azhurnimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën bashkëkohore por edhe thellimi i kërkimit shkencor individual nga ana e pedagogëve kontribuojnë në këtë drejtim

	<i>(Evidenca Nr. 3.10, Syllabus Information; Takim me Stafin Akademik).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit parashikon që transmetimi i njohurive tek studentët, të kryhet nëpërmjet angazhimit të tyre direkt në kërkimin shkencor duke i drejtuar në mënyrën si të kryejnë kërkimin shkencor, duke përfshirë si njohurive metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet mini-eseve, detyrave të kursit apo edhe zhvillimit të mendimit kritik të studentëve. Si për të arritur një nivel të lartë kërkimi ashtu edhe për prezantimin e punës së kryer, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit) <i>(Evidenca Nr. 3.1, Instructors Handbook)</i> . Aftësitë sociale dhe soft-skills zhvillohen kryesisht nëpërmjet projekteve apo edhe punës në grup <i>(Evidenca Nr. 3.4, Social Events Evidence)</i> .
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentët, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studentët gjatë vitit akademik së bashku me aftësitë ndërvepruese, si për shembull soft-skills apo në teknologjitë ICT që analizohen nga pedagogu në përfundimin e lëndës apo te semestrit. Kjo analizë e njohurive të përfituara por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentët për ti adresuar sugjerimet në vijim të studimit akademik <i>(Evidenca Nr. 1.1, Statute)</i> . Pedagogët kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët <i>(Takim me Stafin Akademik)</i> .
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Realizimi i lëndëve dhe programeve në DSHPMN realizohet duke u bazuar në dy kompetenca kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë siç është literatura e rekomanduar, si edhe informacioni nëpërmjet motorëve të kërkimit siç janë google scholar. Në aspektin praktik realizohen në kordinimin e pedagogut zhvillohen diskutime në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më shumë studentë të marrin pjesë. Një aspekt i veçantë i programit lidhet edhe me zhvillimin e praktikave mësimore pranë institucioneve partnere si publike ashtu edhe privatë apo të shoqërisë civile për ti mundësuar studentëve zbatimin praktik të njohurive të marra <i>(Evidenca Nr. 1.25, Curricula Development, Policy and Procedures; Evidenca Nr. 1.30, Study Programmes; Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit, neni 14)</i> . Mobiliteti i studentëve si në ardhje ashtu edhe në dalje nxitet nga zhvillimi i programit në gjuhën angleze <i>(Takim me Stafin Akademik; Takim me Studentët e Programit)</i> .
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë	Personeli akademik organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të

të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	organizuara nga UNYT apo institucione të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogët (<i>Evidenca Nr. 1.18, UNYT Annual Report 2022</i>). Studentët marrin pjesë në aktivitete kërkimore sic është rasti i publikimit të Research Paper nga studenti Mustafa Zenelhasani në konferencën “EU Democracy Promotion: Theory and Practice”.			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pedagogët promovojnë pjesëmarrjen me prezantime të studentëve në aktivitetet shkencore për të inkurajuar më tej idetë e tyre inovative, duke i ofruar për ti motivuar extra-points në provimin përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 1.18, UNYT Annual Report 2022; Takim me Studentëte Programit</i>).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale, por edhe falë mobilitetit të pedagogëve të huaj apo edhe te UNYT. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet akademike dhe në ato kërkimore synon zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblylëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e departamentit përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmblylëse dhe projektin e diplomimit. Përsa i takon programit të masterit shkencor, studentët duhet që fillimisht të përmblyllin të gjitha detyrimet për cdo modul të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin (<i>Evidenca Nr. 3.32, Rregullore e Projektit të Diplomimit</i>). Punimi përfundimtar konsiston në një thesis të cilën studentët fillojnë ta hartojnë në semestrin përmblylës të vitit të dytë të programit (<i>Evidenca Nr. 1.34, UNYT MA in IR Master Thesis Guideline</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion	Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmblylëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmblylljen e programit (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and</i>

të të detyrimeve përmbyllëse.	<i>Regulations</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Departamenti ngre një komision të posaçëm me anëtarët e departamentit për administrimin e punimeve të thesis (dizertacionit) (<i>Evidenca Nr. 1.34, UNYT MA in IR Master Thesis Guideline</i>). Ky komision vlerëson dhe ofron feedback për çdo punim, përpara se të shpallet nga departamenti data e mbrojtjes me gojë të dizertacioneve (<i>Evidenca Nr. 3.9, Diploma Issuing Procedures</i>).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët mund të zgjedhin ndërmjet pedagogëve të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e thesis që mendojnë. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej tema e thesis/dizertacionit. Përcaktimi i udhëheqësit dhe temës i hap rrugën aprovimit të procedurës nga ana e departamentit dhe drejtuesit të tij (<i>Evidenca Nr. 3.9, Diploma Issuing Procedures</i>). Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë me kërkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi. Ky i fundit vendos kur punimi është i gatshëm për tu dorëzuar në komisionin e vlerësimit duke garantuar cilësinë shkencore të dizertacionit (<i>Evidenca Nr. 3.9, Diploma Issuing Procedures</i>).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësit i asistojne studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda IAL për hartimin e dizertacionit, udhëheqësi ofron, kur është e nevojshme ndihmë shtesë nëpërmjet netëork personal jashtë institucionit duke krijuar mundësinë që studentit të marrë ekspertizën e nevojshme për një punë sa më cilësore (<i>Evidenca Nr.1.34, UNYT Master Thesis Guideline</i>).
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Dizertacioni vlerësohet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit, si edhe duke i ofruar studentit feedback lidhur si me aspektet pozitive ashtu dhe me pikat që meritonin më shumë vëmendje. Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 50% (<i>Evidenca Nr. 3.9, Diploma Issuing Procedures</i>).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë	UNYT në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën e Masterit. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e Masterit Shkencor dhe me suplementin e diplomes (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and Regulations neni 70</i>). Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga

zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të vecantë (Evidenca Nr. 2.15, UNYT MSc in IR Sample of Degree).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e rregjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. (Evidenca Nr. 1.7, neni 45 dhe 64, UNYT Rules and Regulations). Kjo Sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar (Evidenca Nr. 5.4, UNYT Records Office, Rules and Regulations). Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë, por edhe rregulloren e këtij arkivi (Evidenca Nr. 5.5, UNYT Archive Regulation).			
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin si nga këshilltari akademik ashtu edhe nga udhëheqësi i tezës finale. UNYT e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën, ashtu edhe diploma suplement.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin	Ky kriter nuk aplikohet

më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me	Bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, vizitën e realizuar në institucion, bisedat me stafin akademik dhe me personelin e zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konfirmon se UNYT dhe më specifikisht Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare e ka si pikë të fortë personelin akademik me tituj dhe grada duke përmbushur standardet e cilësisë (<i>Evidenca Nr.3.8 UNYT Academic Staff CV</i>). Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare në vitin akademik 2020-2021, 2021-2022 dhe vitin 2022-2023 ka angazhuar në realizimin e programeve të studimit stafin akademik me tituj dhe grada si më poshtë vijon:

programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	3	-	3	-	3	-
Dr./PhD.	2	-	2	-	2	-
Msc.	-	-	-	-	-	-
Totali	5	-	5	-	6	-

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (Evidenca Nr. 2.1 Tabelat përmbledhëse Aneks_RVB (IR) për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë angazhuar staf akademik për 3 vite akademike si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 5 PAE (100 %);
2. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 5 PAE (100 %);
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 6 PAE (100 %).



Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit rezulton se profili i ekspertizës së stafit akademik është në përshtatje me lëndët e këtij ofruara në këtë program studimi. Në vijim të sa më sipër, GVJ vëren se kriteri 1 plotësohet. Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik janë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga të dhënat tabelare që janë GVJ ka shqyrtuar në kuadër të këtij procesi rezulton se për të 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar e gjitha nga stafi akademik me kohë të plotë, duke plotësuar kështu detyrimet ligjore në fuqi. (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Përmbledhëse; Tabela 1, fq 2). Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Të dhënat tregojnë së angazhimi i personelit akademik PAE në këtë program studimi është shumë i mira pasi është 100% duke plotësuar kështu edhe kriteret ligjore. Gjithashtu nga

	shqyrtimi i evidencave vërehet qëndrueshmëri përsa i takon dhënies së të njëjtave lëndë nga i njëjti pedagog për vite me radhë. Përgjithësisht ngarkesa mësimore varion nga 90 orë deri në 240 orë konform legjislacionit në fuqi. (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese).
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Për periudhën e akreditimit, dëshmohet qëndrueshmëri e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Kjo konstatohet nga shqyrtimi i dosjeve të stafit akademik dhe dokumentacioni në lidhje me kontratat e punës etj. Dosjet e personelit të vena në dispozicion gjatë takimit me ZBNJ përfshijnë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik. (Evidenca Nr.4.26 UNYT List of Documents for FT Academics; Evidenca Nr.4.28 UNYT Full-Time Indefinite Contract of Employment; Evidenca Nr.4.28.2 UNYT Full-Time fixed-term Contract of Employment)
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Neni 41 i Statutit i titulluar “Procedurat e Rekrutimit” përcakton se “Njësia bazë identifikon dhe propozon nevojën për një vend të lirë...”, miratimi i të cilit realizohet nga Rektori. Gjithashtu neni 42 i titulluar “Punësimi i Personelit Akademik” përcakton se “Personeli Akademik mund të punësohet pranë UNYT me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, dhe mund të ketë status të përhershëm ose jo...” (Evidenca Nr.1.1 Statute, Alb). Departamenti i Burimeve Njerëzore ka një dokument të titulluar “Politika dhe Procedurat” ku ndër të tjera përcaktohet dhe seksioni “Procedura e rekrutimit të Personelit Akademik” që përshkruan hapat që ndiqen në këtë proces, strukturat përgjegjëse etj (Evidenca Nr.4.24 UNYT Human Resources Department - Policies and Procedures. fq.7; Evidenca Nr.4.25.1 UNYT The Standard Format of the Recruitment Procedure). Nga bisedat me stafin akademik dhe nga shqyrtimi i dosjeve, doli qartë se Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi. Kjo zyrë ka përgjegjësi për zbatimin e kriterëve në rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UNYT. Zyra e Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante, duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar (Letër motivimi; CV; Photocopies of credentials and transcripts; A Statement of Research Interests; etj), që garantojnë përzgjedhjen e personelit të kualifikuar.(https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për	Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” nuk parashikon orë laboratorike dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifikë (Evidenca Nr.1.5 CurriculaSchedule), ndonëse UNYT ka laboratorë me kompjutera dhe zyrë TI-së të përbërë nga 2 specialistë. Institucioni ve në dispozicion stafin ndihmës për asistencën

<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>e stafit akademik dhe studentëve. Drejtuesi i Departamentit realizon orarin për zbatimin e planit mësimor të programit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” në bashkëpunim me kryerregjistruesin. Njoftimi i studentëve realizohet nga zyra e sekretarisë mësimore dhe/ose departamenti operacional. (Evidenca RVB IR Shqip)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vizita në institucion, bisedat me personelin e Departamentit të Burimeve Njerëzore, shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, GVJ konfirmon se UNYT ka rregulla të përcaktuara për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe realizon me përgjegjësi mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, atij ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. Për secilin person të angazhuar në UNYT, Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të Dosjes personale të stafit, i ka ato të ruajtura ndër vite (Evidenca Nr.4.24 UNYT Human Resources Department - Policies and Procedures, fq.10-11). Këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (Evidenca Nr.4.23 UNYT Declaration of Consent).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka memorandum dhe marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, ndërmarrje dhe organizata (Evidenca Nr.5.1 UNYT List of MoU-s). Gjithashtu institucioni ka një zyrë të titulluar “Zyra e Karrierës” që realizon udhëzimin drejtë karrierës dhe për praktikën profesionale për studentët (Evidenca Nr.5.11 UNYT Career Office Rules and Regulations, Alb). Ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese).</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale. (Evidenca Nr.2.1 Tabelat Permbledhese)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” përmbush standardet e cilësisë si për nga niveli i kualifikimit, përvoja në punë, qëndrueshmëria në këtë departament, në përputhje me fushën e</p>


	<p>programit, kërkesat ligjore dhe për garantimin e standardeve të mësimdhënies. Zyra e Burimeve Njerëzore ka të përcaktuara qartë në dokumentin e titulluar “Politika dhe Procedurat” rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë programi studimi. Institucioni ka memorandume dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione, ndërmmarrje dhe organizata për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Theksojmë se ky program studimi nuk ka në kurrikul të parashikuar praktikën profesionale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Vizita e GVJ u krye në mjediset UNYT, e cila ndodhet në adresën: Kodra e Diellit, Tiranë. Institucioni ka një sipërfaqe prej 2485.9 m². UNYT garanton mundësi të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore pasi institucioni ka kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Mjediset janë shumë të mira dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Kampusi ka ëi-fi dhe akses në internet. Të gjitha këto mjedise u panë nga GVJ gjatë vizitës në institucion (<i>Evidenca Nr.4.12 UNYT The Surface in Function of Teaching; Evidenca Nr.4.11 UNYT Architectural Report; Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore infrastrukturore të UNYT janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje teknologjike që lehtësojnë procesin e mësimdhënies-mësimnxënies në auditoret e UNYT. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet wi-fi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (<i>Vizita në institucion; Evidenca RVB IR Shqip</i>).</p>

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Kushtet e ambjenteve në UNYT janë mëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” për aftësimin teorik e praktik të studentëve dhe arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën për aksesimin e literaturës (ne hardcopy dhe atë digitale) që lidhet me këtë program studimi. <i>(Vizita në institucion; Evidenca Nr.4.13 UNYT Library Facilities)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në mjediset e UNYT, GVJ konfirmon pajisjen e mjedisëve me teknologji e nevojshme për sigurimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies maksimale. Gjithashtu strukturat përgjegjëse të institucionit operojnë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike në bazë të Manualit të Sigurisë së Sistemit. <i>(Evidenca Nr.4.14 UNYT Manual of Information Security, Eng)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Kapacitetet e UNYT dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor. Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndjhmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologji bashkëkohore të mësimdhënies - mësimnxënies. <i>(Vizita në institucion)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në UNYT, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të këtij programi studimit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi IV.3


Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e UNYT është e pajisur me literaturë fizike dhe atë digjitale. Institucioni ka një dokument të titulluar “Politikat dhe procedurat e bibliotekës” i cili shërben për organizimin e përgjithshëm të aktivitetit në bibliotekë. Literatura që lidhen me natyrën e programit të studimit gjendet në gjuhën angleze (<i>Evidenca Nr.4.9 UNYT Library Policy and Procedures</i>). GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. (<i>Vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Neni 7 i dokumentit “Politikat dhe procedurat e bibliotekës” i referohet “Pasurimit të fondit të Bibliotekës” së institucionit. Bordi i administrimit shpërndan fondet për bibliotekën. Fondet për librat dhe materialet jepen çdo vit. Departamenti propozon një listë të përditësuar me libra për bibliotekën, që janë të përfshirë në literaturën e programit mësimor tek dekani i fakultetit (<i>Evidenca Nr.4.9 UNYT Library Policy and Procedures, fq.6</i>). Dokumenti i titulluar “Raporti i blerjeve të librave” e vërteton këtë proces (<i>Evidenca Nr.4.1 UNYT Books Report</i>). Fondi i dedikuar pasurimit të bibliotekës varion nga 15.000 deri në 20.000 euro. (<i>Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës e cila ndodhej në katin e 2-të të ndërtesës së UNYT me një hapësirë 215 m². Biblioteka është e ndarë në dy ambjente kryesore. Një pjesë i është rezervuar hapësirës së studimit dhe koleksionit të titujve dhe një hapësirë tjetër është e pajisur me 12 PC për të mundësuar aksesin e literaturës digjitale nga studentët, stafi akademik apo ai administrativ. Këto të dhëna tregojnë se për numrin e studentëve të këtij programi studimi, Biblioteka garanton mundësi për të gjithë me kompjutera për aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit. (<i>Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës</p>	<p>Biblioteka e UNYT është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programit të studimit. Biblioteka ka të kataloguar 8100 tituj akademik dhe 8480 volume si dhe ofron akses në bibliotekën elektronike. Institucioni ka një katalog elektronik të titujve: https://library.unyt.edu.al/. Investimi i institucionit në fondin e bibliotekës shkon rreth 190.000 euro. (<i>Evidenca Nr.4.9 UNYT Library Policy and Procedures; Evidenca RVB IR Shqip</i>)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 43




së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UNYT i krijon kushte studentëve, stafit akademik dhe administrativ, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online si bibliotekat dixhitale JSTOR, PROQUEST, EBSCO, Emerald insight, APA, GALE etj, ku mbulohen të gjitha fushat e shkencës e teknologjisë, përfshirë edhe shkencat politike e shoqërore. <i>(Evidenca RVB IR Shqip; Vizita në institucion)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur ëi-fi dhe ka 12 PC të lidhur në rrjet të cilët janë në dispozicion te frekuentuesve të saj.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur çdo ditë të javës. Gjatë javës ajo funksionon nga ora 9.00 deri në orën 21.30 dhe në fundjavë mjediset e saj mbyllen në orën 17.00 ditën e shtunë dhe orën 18.00 ditën e djelë <i>(Evidenca Nr.4.13 UNYT Library Facilities)</i> . Orari i shërbimit është në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave të studentëve dhe stafit.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	UNYT vit pas viti realizon pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë dhe përmes abonimeve në bibliotekat digjitale krijojnë infrastrukturën për rritjen e aksesimit në këto biblioteka. Bazuar në RVB frekuentimi ditor i bibliotekës shkon në 80-100 përdorues. Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shakallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. <i>(Evidenca RVB IR Shqip; Vizita në institucion)</i>
Konkluzione	<i>GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion për marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies që ju mundëson stafëve akademike t'i referojnë në syllabuset dhe studentëve t'i përdorin ato. Biblioteka e UNYT është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe në përputhje me natyrën e programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesimi në platformat digjitale që janë të aksesueshme pa</i>

	<i>pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistem të menaxhimit të informacionit me në qëndër studentin i quajtur GNOMON i cili shërben për komunikimin e brendshëm. Ky sistem përfshin komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe ju mundëson informim në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi përdoret nga disa departamente të institucionit sipas aksesit dhe detyrave që lidhen me secilin prej tyre. Administrimi i informacionit në këtë platformë realizohet në mënyrë korrekte, duke i shërbyer stafit akademik dhe studentëve për të parë ecurinë e punës së tyre. <i>(Evidenca Nr.4.20 UNYT Gnomon Platform; Evidenca Nr. 4.20.3 UNYT Gnomon Student Search; Evidenca Nr. 4.21 UNYT Academics' Access)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Njësia përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrative është Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë disponon në dy versione atë në hardcopy dhe të skanuar dosjen e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrative. Zyra e Burimeve Njerëzore realizon përditësimin e dosjeve të stafit bazuar në kërkesat dhe ndryshimet ligjore të Republikës së Shqipërisë.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale në sistemin GNOMON. Personeli që sapo emërohet dhe studentët që sapo rregjistrohen pajisen me adresat e personalizuara të aksesit në informacionet e universitetit. <i>(Evidenca Nr.4.19 UNYT E-mail adress for each student; Evidenca Nr.4.21 UNYT Academics' Access)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	Përmes sistemit të menaxhimit GNOMON realizohet aksesit i dedikuar në bazë të programeve të studimit për stafin dhe studentët. Ky system

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 45



komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	menaxhimi mundëson të dhëna të ndryshme por nuk ofron ndërveprim ndërmjet stafit dhe studentëve. Komunikimi i stafit dhe studentëve realizohet me e-maile, Canvas, McGraë ose drejtpërdrejt. <i>(Evidenca RVB IR Shqip)</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemit të menaxhimit GNOMON bënë të mundur komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe i mundëson akses studentëve dhe stafit akademik si dhe disa departamenteve të institucionit informim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ për studentin nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi mundëson raportime statistikore. <i>(Evidenca RVB IR Shqip)</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ kontrollon informacionin e disponueshëm në faqen online të UNYT https://unyt.edu.al/ e cila është në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Faqja është e pasur me informacionin të nevojshëm për studentët, personelin akademik dhe të gjithë personat e interesuar mbi programin e studimit dhe aktivitetet e ndryshme.			
Konkluzione	<i>UNYT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion në kohë reale të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Faqja online e UNYT është në dy gjuhë shqip dhe anglisht, si dhe e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB dhe dokumentin e titulluar “Pasqyrat financiare vjetore” konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit <i>(Evidenca Nr. 4.33 UNYT Financial Statements 2020; 4.33.1 UNYT Financial Statements 2021)</i> . Raporti financiar vjetor përmbajnë të dhëna të hollësishme që lidhen me pozicionin financiar, performancën apo fluksin e mjeteve monetare për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. <i>(Evidenca RVB IR Shqip)</i>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Burimet financiare të UNYT janë: a) Tarifa për dhe gjatë shkollimit që paguajnë studentët; b) Financimet nga Fondacioni Maarif; c) Të ardhurat e projekteve kërkimore (<i>Evidenca Nr.4.33.1 UNYT Financial Statements 2021, fq.13-14</i>). Institucioni ka një “Politikë Buxhetore” (dokument i miratuar më 15.12.2021) ku parashikohen hapat që duhet të ndjekë përgatitja e buxhetit; diskutimi; përshtatja dhe miratimi i buxhetit të institucionit (<i>Evidenca Nr.4.34 UNYT Budgeting Procedure</i>). Shpërndarja e burimeve të sipërcituara realizohet në planifikimin buxhetor për çdo njësi akademike e cila aprovohet në fillim të çdo viti (<i>Evidenca Nr.4.31 Budget Plan</i>). Miratimi i buxhetit realizohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UNYT.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim vjetor periodik përmes auditimit të jashtëm nga shoqëri që ofrojnë këtë shërbim. Në vitin 2021 ky proces është realizuar nga Shoqëria audituese “Euro-audit consulting co” (<i>Evidenca Nr.4.30 UNYT External Auditing Report</i>)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në nivel institucioni realizohet raport financiar përmbledhës i cili është i përvitshme. Bazuar në RVB raportet periodike realizohen në transparence dhe bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë përsa i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Burimet e financimit që institucioni ka bëjnë të mundur qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të tij. Bazuar në RVB theksohet se mbështetja financiare nga Fondacioni MAARIF i ka dhënë qëndrueshmëri dhe siguri financiare zhvillimit të programeve të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit përmes tarifave studentore, financimit nga Fondacioni MAARIF, të ardhurat nga projektet etj. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve UNYT i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi sic janë Ligji i Arsimit të Lartë udhëzimi “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës”, por edhe dhe rregulloreve të brendshme të hartuara nga institucioni sic janë vendimi i Senatit nr.89 datë 27.01.2023, i cili rregullon në mënyrë më të detajuar këto procedura. UNYT kërkon edhe si kriter shtesë mbrojtjen e gjuhës angleze pasi studimi dhe vlerësimi i studentëve bëhet në gjuhën angleze (<i>RVB fq. 51</i>).</p> <p>Senati akademik është organi që përcakton kuotat e studentëve për çdo vit akademik në bazë të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të institucionit. Bazuar në aplikimet e marra përmes portalit U-Albania, UNYT përgatit listën e studentëve fitues dhe pas publikimit në portalin e U-Albania ato publikohen edhe në faqen web të IAL (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and Regulations neni 62</i>). Rregjistrimi bëhet duke u mbështetur në udhëzimin nr. 10 “Procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në IALs”. Në këtë program studimi janë regjistruar studentë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ 2022-2023 6 studentë ➤ 2021-2022 3 studentë ➤ 2020-2021 6 studentë ➤ 2019-2020 2 studentë ➤ 2018-2019 8 studentë <p>Ajo që vihet re është së studentët e pranuar në këtë program studimi kanë një mësatë në hyrje të lartë që varion 8.35 në 9.93.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 48

	<p>Pas rregjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matriculimi nga QSHA dhe me kartën e studentit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Ndërkohë që për të ofruar një perspektivë sa më të plotë të aktivitetit në UNYT, institucioni organizon ditë të hapura me studentët (<i>Evidenca Nr. 5.3.2, UNYT Quotas for the Academic Year 2022-2023</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në nenin 6 të statutit “Liria Akademike dhe Mundësitë e Barabarta”, UNYT sanksionon barazinë ndërmjet studentëve pavarësisht racës, fesë, origjinës etnike, orientimit seksual, statusit personal apo paftësive fizike, si edhe mbështet diversitetin (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti</i>).</p> <p>Rregullorja përmban në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga rregjistrimi, deri tek përfundimi i studimeve apo transferimet në programe të tjera studimi duke ofruar një proces transparent dhe barazi në trajtimin e studentëve (<i>Evidenca Nr. 4.7, UNYT Code of Ethics</i>). Ndërkohë për një trajtim të barabartë dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi funksionon Këshilli i Eitkës në nivel universiteti, i cili sanksionon të gjitha të drejtat e parashikuara në rregulloren e kodit të etikës për studentët dhe stafin (<i>Evidenca Nr. 4.7, UNYT Code of Ethics</i>). Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike mbështet studentët që kanë më shumë nevojë për ndihmë për adaptim individual dhe ambientim social në jetën e universitetit (<i>RVB fq.52</i>). Studentëve i granatohet e drejta e ankimimit kur ndeshen me shfaqje të pabarazisë në aktivitetin e tyre (https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/). Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara (<i>Vizita në institucion</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton në rregjistrimin e studentëve në respekt të legjislacionit në fuqi sic janë: Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave; si edhe kuadri ligjor institucional specifikuar në vendimin e Senatit nr. 89 datë 27/01/2023.</p> <p>Sipas urdhërit numër 8 date 30/06/2022, UNYT shkarkon cdo vit listat e aplikantëve për secilin program dhe kryen renditjen e fituesve, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria (<i>Evidenca Nr. 5.3.2, UNYT Quotas for the Academic Year 2022-2023</i>). Kriteret e pranimit për studentët e huaj rregullohen me udhëzimin e senatit akademik Nr. 17 datë 30/07/2019 “Për procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë” kreu IV.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të</p>	<p>Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimit në universitet në përputhje me nenin 76 të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë”, si edhe rregulloren e UNYT neni 6 pika e. Në rastin e studentëve me diplomë të huaj është i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 49


<p>dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>nevojshëm ekuivalentimi i diplomës sipas dispozitave në fuqi. Karakteristikë e institucionit është kriteri i njohjes së gjuhës angleze. Nëse aplikanti nuk ka si gjuhë amëtare anglishten atëherë sipas udhëzimit nr. 11 datë 10.04.2017 dëshmi të aftësisë së gjuhës angleze (TOEFL, IELTS, TOEIC, APTIS në nivelin B2). Në rast të kundërt kandidatëve u kërkohet të marrin pjesë në një provim të gjuhës angleze APTIS ofruar nga British Council në universitet.</p> <p>Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.10 datë 15/05/2019, çdo kandidat duhet të sjellë pranë sekretarisë mësimore dokumentat e mëposhtëm: a) formularin e aplikimit; b) Letër Motivimi; c) Kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave të Bachelor; d) kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave të shkollës së mesme; e) CV; f) një kopje të ID ose pasaportës; g) 4 fotografi pasaporte; j) certifikatën e mbrojtjes së gjuhës angleze (B2) (<i>Evidenca Nr. 5.22, Study Programmes</i>). Kriteret e pranimi janë publikuar në faqen zyrtare të UNYT, si edhe i prezantohen studentëve gjatë takimit në Zyrën e Cështjeve të Studentëve.</p> <p>Pranimi i transferimit të studentëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa transferimi i krediteve vlerësohet nga një komision ad-hoc i ngritur në nivel departamenti dhe aprovohet nga dekani i fakultetit përkatës. Ky vendim bazohet në listën e notave dhe përshkrimin e secilës lëndë (syllabuse) të marra në universitetin ku ka ndjekur studimet. Sipas rregullores së UNYT neni 7 pika g, komisionet nuk mund të njohin më shumë se 40 kredite transferimi për ciklin e dytë të studimeve në përputhje me Urdhërin e Këshillit të Ministrave n. 41 datë 24/01/2018, pika 2.1.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UNYT informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes web (www.unyt.edu.al) ku I ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve dhe stafit të UNYT, lidhur me karakteristikat e programeve të studimit, kurrikulat, si edhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni.</p> <p>Një sërë aktivitetesh marketingu si reklama, orë të hapura, takime promovuese, të organizuara nga UNYT apo publikime si broshuara, students-book, etj synojnë tërheqjen e sa më shumë studentëve (<i>Evidenca Nr. 5.22, UNYT Promotion Materials</i>). Për të tërhequr më shumë maturan të, UNYT organizon kurse falas online në matematikë ku maturan të nga e gjithë Shqipëria mund të marrin pjesë, ndërsa zhvillohen kurse parapërgatitore për hyrjen në universitet në degë të tilla si arkitektura (online dhe në prezencë) për ta bërë sa më të thjeshtë integrimin në vitin e parë për studentët që do të vijnë pranë UNYT (<i>Evidenca Nr. 5.23, UNYT Study Programmes</i>). Universiteti organizon edhe provimin e bursës për t'iu dhënë studentëve ekselentë mundësinë për të përfutur 100% bursë gjatë periudhës së studimeve (<i>Evidenca Nr.</i></p>

	5.23.1, UNYT Scholarship Policy).			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UNYT publikon në fillim të çdo viti kuotat në dispozicion të studentëve që vijnë nga disa kategori të vecanta sociale, në zbatim të kritereve që janë vendosur nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr. 17, datë 30/07/2019. (Evidenca Nr. 5.3.2, UNYT Quotas for the Academic Year 2022-2023).			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kuotat e pranimit për studentët me shtetësi të huaj publikohen përpara çdo viti akademik dhe kriteret që ndiqen janë ato të publikuara nga Ministri e Arsimit për këtë qëllim. Kandidatët me shtetësi të huaj duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pranimin në programet e ciklit të parë dhe të dytë. Sic e përmendëm më lart, kriteret e mësipërme në rastin e UNYT pasurohen edhe më tej me zotërimin e gjuhës së huaj, kritere të cilat janë miratuar nga Senati Akademik (Evidenca Nr. 5.3.2, UNYT Quotas for the Academic Year 2022-2023).			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Komiteti i Bursave ofron mbështetje financiare pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë Zyrës së Ceshtjeve të Studentëve (SAO) (Evidenca Nr. 5.23.2, UNYT Scholarship Policy 2022-2023 neni 22). Sipas legjislacionit të IAL, kandidatët mund të përfitojnë bursa deri në masën 100% në bazë të kritereve si: mesatarja e gjimnazit, arritje kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa kategorite e tjera marrin si kriter vlerësimi notën mesatare të përfundimit të gjimnazit: a) 9.0-9.49 përfitojnë 25% të bursës; b)) 9.5-9.79 përfitojnë 50% të bursës; c) 9.8-9.99 përfitojnë 75% të bursës; d) 10 përfiton 100% bursë (Evidenca Nr. 5.23.2, UNYT Scholarship Policy 2022-2023).			
Konkluzione	UNYT ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike, përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. Një kujdes i vecantë tregohet për matjen e përparimit të studentëve duke zbatuar forma të ndryshme të vlerësimit si gjatë vitit akademik ashtu edhe në përfundim të tij. UNYT ka një legjislacionin të qarte institucional për transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studenti njihet me rregulloren e programit, e cila përcakton kriterit e kalimit nga një vit akademik në tjetrin në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit (<i>Evidenca Nr. 1.10, Rregullore e Programit - MA në Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>). Staf i akademik me kohë të plotë ka akses në sistemin e menaxhimit vetëm për tu njohur me rezultatet e studentëve, për të verifikuar ecurinë e studentëve, dhe për të bërë këshillimet e nvojshme mbi progresin akademik (<i>Evidenca Nr. 4.21, UNYT Academic's Access</i>).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Cështjeve të Studentëve ofron informacion mbi procedurat e njohjes së diplomës, informacion shtesë për studentët e huaj, si edhe udhëzime mbi procedurat e transferimit duke shpjeguar kriteret - sic u sqarua më lart - për njohjen e krediteve dhe duke informuar më pas studentin për kreditet e njohura nga komisioni i ngritur për këtë qëllim (<i>Evidenca Nr. 5.21, UNYT Transfer of Studies and Documents</i>). Për tu diplomuar, studentët duhet të fitojnë për të paktën ½ e krediteve pranë UNYT, ndërsa kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Rektoratit (<i>Evidenca Nr. 5.24, UNYT Communication ëith International Students</i>).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	IAL operon me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si njësi matëse e ngarkesës akademike. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si edhe kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Rregulloren e Programit (<i>Evidenca Nr. 1.10</i>). Seksioni 15 i syllabus të cdo lënde të ofruar përcakton edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve dhe kriteret e vlerësimit (<i>Evidenca Nr. 3.2, e-Learning Platform</i>). Në një lëndë tipike dijet e përfituara vlerësohen sipas këtij klasifikimi: a) Provimi i Ndërmjetëm (30% e notës përfundimtare); b) Provimi Përfundimtar (40% e notës përfundimtare); c) pjesëmarrje aktive e studentit në klasë (10% e notës përfundimtare); d) komponentë të tjerë si detyra kurse, raste studimore, apo pune laboratorike vlerësohen me 20% të notës përfundimtare (<i>Evidenca Nr. 5.4, UNYT Records Office Rules and Regulations</i>).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në	Një rregullore e vecantë është miratuar për provimin përfundimtar apo punimin e diplomës (rregullorja e Projektit të Diplomimit) por edhe rregullorja e Fakultetit (neni 16, 17), e Departamentit neni 15, 16, 17) e programit të studimit neni 26, 29, 30) përcaktojnë të gjitha parakushtet




programin e studimit.	dhe procedurat për projektin e diplomimit. Informimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura është detyrë e departamentit (<i>Evidenca Nr. 3.3, UNYT Rregullore e Projektit të Diplomimit</i>).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Zyra për Ceshtjet Studentore organizon dhe zhvillon takime me maturantët për tu ofruar atyre informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit në UNYT. Kjo zyrë merr pjesë edhe në panairë të organizuara ku ofron udhëzime dhe informacione për kandidatët e mundshëm (<i>Evidenca Nr. 5.33, UNYT SAO Annual Plan</i>).			
Konkluzione	<i>UNYT ofron mjete të ndryshme për njohjen e programit nga ana e studentëve dhe këto përfshijnë si transparencën online me informacion të hollësishëm për programin e studimit, javën hyrëse ku pedagogët pjesëmarrës japin informacionin e nevojshëm, këshilltarin akademik apo edhe zyrën për ceshtjet studentore që shërbejnë si pikë reference për studentëve e programit të studimit për të dhënë një informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin në fjalë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Zyra e Ceshtjeve Studentore (SAO) informon studentët mbi strukturën e programeve duke harmonizuar takimet në zyrë me informacionin në faqen zyrtare https://unyt.edu.al/index.php/master-programs/ ku studentët gjejnë të gjithë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit, sic janë kohëzgjatja e programit, tarifat e studimit, përbërja e lëndëve etj. Studentëve ky informacion mund ti ofrohet edhe i printuar, por edhe u krijohet mundësia për tu takuar me pedagogët dhe për të marrë më shumë informacion mbi programin. SAO por dhe këshilluesi akademik u ofrojnë studentëve në javën e parë të studimit një informacion të detajuar mbi provimet, mënyrën e vlerësimit, etj https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/
Kriteri 2. Institucioni vë në	Studentit i ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm si p.sh. syllabuset

<p>dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>që në javën e parë të studimeve, ndërsa cdo student ndiqet nga një këshillues akademik që është pjesë e departamentit. Në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore, këshilluesi informon studentin mbi planin mësimor, modulet, përmbajtjen e lëndëve. Studentët informohen gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomes (<i>RVJ p.57, Takim me Studentët</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UNYT ka një Zyrë Karriere, e cila i informon studentët në lidhje me nevojat e tregut të punës duke falë seancave këshillimore për studentët që duhet të njihen me mundësitë e punësimit apo praktikave që mund të ndjekin pranë institucioneve të ndryshme (<i>Evidenca Nr. 5.1, List of MoUs</i>). Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Karrierës është organizimi i Panairit të Punës, i cili mbledh së bashku përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, dhe Alumni të diplomuar në UNYT (<i>Evidenca Nr.5.12, UNYT Career Office Rules and Regulations</i>). Në Panairin e fundit morën pjesë 38 kompani të cilat ofruan mundësi punësimi apo praktikash për studentët (<i>Evidenca Nr. 5.17, UNYT Open Days and Students Visits</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për studentët (<i>Evidenca Nr. 5.17, UNYT Open Days and Students Visits</i>).</p> <p>Këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara për këtë qëllim në fillim të çdo viti akademik nga të gjitha strukturat e UNYT në shërbim të studentit (<i>Takim me përfaqësuesit e Zyrës për Çështjet Studentore</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Pasi studentët rregjistrohen në UNYT, zyra e IT u siguron një emër përdorimi dhe kod për të patur akses në listën e tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Kjo procedurë kryhet në sistemin e menaxhimit (e-GNOMON) dhe aksesit i mundësohet në çdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programet e studimit dhe syllabusët përkatëse janë në dispozicion të studentëve duke përfshirë si format e vlerësimit objektivat mësimore që pritet të arrihen në përfundim të kursit, si edhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së këtyre objektivave formuese.</i></p> <p><i>Struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me këshilltarin akademik dhe stafin ndihmës të programit. Përtej programit të studimit, organizohen me ndihmën e alumni edhe panairë për tu dhënë mundësinë studentëve të njohin tregun e punës por edhe pedagogëve për të kuptuar nevojat reale të tregut, në mënyrë që kurrikula të përshtatet sa më mirë me këto nevoja për të rritur kështu mundësitë e punësimit të studentëve. Aktualisht</i></p>




	<i>programi ka një normë punësimi të studentëve prej 100%.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4



Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Statistikat mbi numrin e studentëve, shpërndarjen e tyre sipas programeve, notat e marra, studentët e diplomuar apo edhe të punësuar përditësohen çdo vit nga UNYT (<i>Takime me Sekretarinë Mësimore</i>). Këto të dhëna dokumentohen në “Dokumentin e Performancës”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL. Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit, emrat e kompanive apo insitucioneve ku janë punësuar (<i>Evidenca Nr. 5.33, UNYT SAO Annual Plan</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi i menaxhimit të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve (performancën akademike dhe situatën financiare). Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale e studentëve që janë në programeve të studimit, atyre që janë shkëputur për kohësisht apo përgjithmonë (<i>Evidenca Nr. 5.33, UNYT SAO Annual Plan</i>). Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni (<i>RVB fq.58</i>).
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për të mbrojtur të dhënat personale të studentëve, të cilat menaxhohen përmes platformës së brendshme të UNYT, departamentet që mund të kenë akses e kanë këtë akses të kufizuar. Sekretaria mësimore e përdor këtë platformë jo vetëm për të hedhur të dhëna por edhe për të vënë në dispozicion të dhënat që nevojiten për analizat, raportet apo hartimin e strategjive të institucionit (<i>Takim me Sekretarinë Mësimore</i>).
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore,	Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, insitucioni ka ngritur një komision ad-hoc, i cili ka si objektive kontrollin e procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 55

sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	funksionimit të zyrave administrative (<i>Evidenca Nr. 6.20, UNYT Rectorate Decision for the Internal Audit</i>).			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sic u përmend më lart, Sekretaria Mësimore vë në dispozicion të Departamentit përkatës të dhënat e nevojshme për hartimin e raporteve dhe analizave përsa i takon numrit të studentëve të regjistruar dhe diplomuar, apo shkëputur nga programet e studimit. Ndërkohë Zyra e karrierës dhe Alumnit kontribuojnë në hartimin e raporteve të ndryshme duke ofruar një pasqyrë të studentëve të diplomuar, punësimin e tyre dhe profilet e punësimit. (<i>Evidenca Nr.2.1, Tabelat e Përmbledhura si Aneks, tabela 21</i>)			
Konkluzione	<i>Strukturat e UNYT bëjnë një punë të vazhdueshme për të mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhëna të hollësishme lidhur me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, shoqëruar me të dhëna për punësimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në nenin 67 të Statutit, UNYT saknksionon pjesmarrjen e studentëve në vendimmarrjet institucionale (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UNYT</i>). Gjithashtu në nenin 41 të Rregullores së Departamentit (<i>Evidenca Nr. 1.9</i>) parashikohet edhe përfshirja e një studenti të zgjedhur nga Unioni i Këshillit Studentor në komisionin disiplinor për të shmangur mundësinë e një konflikti interesi në përzgjedhjen e studentëve në insitancat vendimmarrëse të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse	UNYT saknksionon në aktet ligjore institucionale të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në vendimmarrje siç janë Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, Unioni Studentor (<i>Evidenca Nr. 6.19, Involvement of Students in Quality Assurance</i>). Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës

dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit (<i>Takim me Grupin e Punës për Hartimin e RVB</i>)			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Si anëtarë të Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve (<i>Evidenca Nr. 6.9, Sample of Student Evaluation Form</i>). Studentët kontribuojnë gjithashtu edhe nëpërmjet opiniove të shprehura në anketimet e kryera pas përfundimit të lëndës apo edhe në takimet me pedagogët përkates (<i>Takim me Studentët e Programit</i>).			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësia/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtën e ankimit nëpërmjet një formulari të caktuar, i cili i vihet në dispozicion si në mënyrë elektronike ashtu edhe të printuar https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/ SAO merr në shqyrtim peticionin e dorëzuar nga studentët por edhe mbledh të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me ankesën apo kërkesën e paraqitur nga studenti dhe e paraqet pranë komitetit të peticioneve akademike ose administrative që përbëhet nga tre anëtarë (<i>Evidenca Nr. 5.29, Academic Petition</i>). Komiteti merr në shqyrtim kërkesën/ankesën dhe vendos nëse pranohet apo jo. Ky vendim i komunikohet studentit si nëpërmjet email ashtu edhe verbalisht nga SAO.			
Konkluzione	<i>UNYUT i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet anketave të lëndës ashtu edhe procesit të ankimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e studentëve. Kjo realizohet falë përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, që veprojnë në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura	Zyra e Cështjes së Studentëve (SAO) funksionon në bazë të

<p>e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>rregulloreve dhe në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e organeve përkatëse të institucionit dhe Ministrisë së Arsimit (<i>Evidenca 1.7, UNYT Rules and Regulations, neni 46</i>). Ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre (<i>Evidenca Nr. 5.31, UNYT SAO Rules and Regulations</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>SAO informon studentët përmes emaileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes informacionit të vënë në dispozicion në faqen e internetit lidhur me karakteristikat e programeve të studimit https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/. Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjestarët e stafit akademik përgjegjës për programin, ndërsa informacioni më i detajuar lidhur me planin mësimor, syllabus i lëndëve, datat e provimeve etj ofrohet nga këshilluesi akademik (<i>Evidenca Nr. 3.2, UNYT Screenshot of the e-learning platform</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës dhe këshillimin e strukturave akademike të universitetit lidhur me këto nevoja, dhe ndan këtë informacion si me Zyrën e Cilësisë ashtu edhe me departamentet përkatëse, në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të kërkuara në tregun e punës (<i>Evidenca Nr. 5.16, UNYT Annual Plan Career Office</i>).</p> <p>Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillimin e nevojshëm lidhur me mundësitë e karrierës si nëpërmjet takimeve individuale ashtu edhe nëpërmjet informacionit të përfshirë në analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun (<i>Evidenca Nr. 5.11, UNYT Career Office Rules and Regulations</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në database të Zyrës së Karrierës dhe Alumni përfshihen të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha nivelet akademike, si edhe identifikohet niveli i punësimit për këta studentë duke e integruar në Dokumentin e Performancës që përgatitet në përfundim të çdo viti akademik (<i>Evidenca Nr. 5.19, UNYT Employment of Students</i>). Ky informacion ndahet me drejtuesit e programeve, dekanët dhe rektoratin për të parë se çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Kontaktet me industrinë dhe insitucionet mbahen nga kjo Zyrë falë edhe kontakteve që ata kanë marrë në mënyrë të vazhdueshme me Alumni (<i>Evidenca Nr. 5.32, UNYT Performance Document</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UNYT ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve sic janë keshilltari akademik apo edhe pedagogët e lëndës të cilët së bashku me zyrat ndihmëse ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. Një procedurë e vecante siguron menaxhimin e ankimeve e problematikave, nga zyrat përkatëse sic është ajo e Ceshjteve Studentore, struktura të cilat</i></p>

	<i>ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Strategjia institucionale e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit 2020-2025 përfshin rishikimin e programeve mësimore, jo vetëm për të sansksionuar këto aktivitete por edhe për t’iu përgjigjur nevojave të tregut (<i>Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook</i>). Për aplikimin e këtyre strategjive, stafi institucionit merr pjesë në trainimet e organizuara nga NJSBC dhe ekspertët e jashtëm. Ky training fokusohet tek mobiliteti i stafit, jo vetëm për të rritur kapacitetet profesionale të tij, por edhe për të krijuar më shumë mundësi për ndërkombëtarizim.</p> <p>Punë e vecantë bëhet me pedagogët e rinj të cilët trainohen nga shefat e departamenteve përsa i takon mënyrës së përgatitjes së programeve, kurrikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse (<i>Evidenca Nr. 3.1, UNYT Instructors Handbook</i>). Programet dhe platformat online janë gjithashtu një tjetër mundësi që ka stafi dhe studentët për tu njohur me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies (<i>Evidenca Nr. 5.25, UNYT Staff Exchange</i>).</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, (KPSSC) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Departamentet përkatëse në secilin fakultet, përbëjnë strukturat përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UNYT neni 32</i>). KPSSC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 59




ndihmësakademik.	<p>për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësisve akademike dhe atyre mbështetëse për studentët, për të garantuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi (<i>Evidenca Nr. 6.3, Regulation of the Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i>). Ky komision është i përbërë nga 5 anëtarë që përfaqësojnë të gjithë departamentet dhe studentët (<i>Evidenca Nr. 6.3, Regulation of the Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i>). Nën monitorimin e KPSSC, NJSBC harton anketat për studentët, të cilët kryhen dy herë në vit.</p> <p>Rezultatet e anketave i vihen në dispozicion të rektoratit dhe drejtuesit të departamentit, i cili i përfshin në raportin vjetor të departamentit, ku paraqiten vlerësimet për stafin akademik dhe ndihmës-akademik. Këtij vlerësimi i shtohet edhe ai i kolegëve për njëri-tjetrin dhe të gjitha këto vlerësime diskutohen në prani të përgjegjësit të departamentit (<i>Evidenca Nr. 6.10, Individual Assessment Performance Form</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>UNYT nxit përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies (<i>Evidenca Nr. 5.29, Academic Petition</i>). Këto pyetësore jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studenteve, ndërsa mënyra për ta shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimimit (<i>Evidenca Nr. 6.9.1, Student Evaluation Report</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në kuadër të transparences institucionale, KPSSC dhe NJSBC publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UNYT https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Për të nxitur zhvillimin profesional të stafit UNYT në fillim të cdo viti akademik krijon mundësinë për vlerësimin e stafit duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (<i>Evidenca Nr. 4.29, UNYT Senate Decision</i>). Shefi i departamentit ia përcjell këto raporte dekanit, të cilët bashkarisht i kërkojnë pedagogëve të vlerësojnë se si janë plotësuar këto objektiva (<i>Evidenca Nr. 4.29.1, UNYT Senate Decision</i>). Rektorati më pas i shqyrton vlerësimet e performancës individuale dhe vendos për promovimin e përgjegjësve dhe mbështjetjen për kërkimet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca etj (<i>Evidenca Nr. 5.32, UNYT Performance Document</i>). Këto vlerësime i shtohen atyre nga kolegët, studentët, takimet personale me stafin akademik, etj (<i>Takim me Stafin Akademik</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse sic janë KPSSC apo edhe NJSBC, metodologjitë dhe mjetet përkatëse për të zhvilluar këtë monitorim, si edhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sic u shpjegua më lart UNYT kas strukturat e nevojshme të sigurimit të cilësisë por edhe procedurat e zhvilluara për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UNYT neni 32</i>). Kjo sanksionohet edhe në Planin Strategjik të UNYT 2020-2025, ku rritja e cilësisë akademike, mësimdhënia, por edhe përmirësimi i shërbimeve logjistike paraqiten si objektiva strategjike (<i>Evidenca Nr. 1.6, UNYT Strategic Plan</i>). Për të mbështetur më tej zbatimin e këtyre procedurave KPSSC ka hartuar rregulloren përkatëse, Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (<i>Evidenca Nr. 6.1, UNYT Quality Assurance Material</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë KPSSC dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e insitucionit dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Manualin e Cilësisë. KPSSC përbëhet nga 6 anëtarë të stafit akademik dhe një përfaqësues i studentëve, ndërsa NjsBC përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik (<i>Evidenca Nr. 6.1 UNYT Quality Assurance Material</i>). I zgjedhur nga Senati akademik dhe me një mandat 2-vjecar KPSSC së bashku me NJSBC janë strukturat përgjegjëse për kontrollin e cilësisë (<i>Evidenca Nr. 6.2, UNYUT Annual Report NjsBC</i>).</p> <p>NjsBC në bashkëpunim me fakultetet dhe departamentet organizon dhe finalizon formën e vlerësimit dhe performancën e pedagogut (<i>Takim me përfaqësues të NjsBC</i>). Të dhënat përpunohen nga kordinatori i NjsBC dhe përfshijnë të gjitha format e vlerësimit për pedagogun i.e. a) Raporti i Vlerësimit të Studentit; b) Raporti i vlerësimit nga kolegët; c) Raporti i Performancës Individuale; Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahusueshmërisë dhe Auditimit (<i>Evidenca Nr. 6.1, UNYT Quality Assurance Material</i>). Të gjitha këto raporte përfshihen në raportin përfundimtar të departamentit.</p> <p>NjsBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësisve aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale (<i>Evidenca</i></p>

	<i>Nr. 6.8, UNYT Internal Audit Procedure).</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Manuali i Sigurimit të Cilësisë është dokumenti bazë për KPSSC për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sigurimi i jashtëm në UNYT realizohet nëpërmjet proceseve të akreditimit, dhe Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për këtë qëllim (<i>Evidenca 6.1, UNYT Quality Assurance Manual</i>). Për të plotësuar sa më mirë rekomandimet e lëna gjatë akreditimeve, KPSSC dhe NJSBC hartojnë një plan që ndjek në vijimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve. (<i>Evidenca Nr. 6.12, UNYT Institutional Accreditation</i>). UNYT është në proces akreditimi me Agjensinë e Sigurimit të Arsimit të Lartë në Turqi (<i>RVB fq.66</i>).			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Strukturat e ngarkuara për sigurimin e cilësisë gjenerojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart. Raporti i Paanshmërisë dhe transparencës është një tjetër mënyrë e evidentimit të cilësisë dhe hartohet nga drejtuesi i departamentit (<i>Evidenca Nr. 6.2.1, UNYT Annual Report NJSBC</i>). Raportet i dorëzohen Pergjigjësist të Departamentit, Dekanit dhe Rektoratit duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse të NJSBC dhe KPSSC për përmirësimin e mëtejshëm të punës (<i>Takim me Përfaqësues te NJSBC dhe KPSSC</i>). Për pedagogët e rinj ekziston dhe një formë tjetër vlerësimi e përgatitur nga pedagogët më me përvojë (<i>Takim me Stafin Akademik të Programit</i>).			
Konkluzione	<i>UNYT harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke harmonizuar forma të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve, vetëvlerësimi i pedagogëve apo vlerësimi nga kolegët e tyre, rezultate të cilat harmonizohen në raportet përkatëse dhe zbatohen me udhëzimet e nevojshme nga strukturat e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 62

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Procesi i mbikëqyrjes së programeve të studimit bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti për tu plotësuar gjatë vitit akademik (<i>Evidenca Nr. 1.10, Rregullore e Programit MA në Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>). Në përfundim të çdo viti akademik nga rektorati kërkohet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre objektivave, si edhe kryhet vlerësimi i stafit akademik në lidhje me realizimin e objektivave të marra, si edhe hartohet një plan veprimi për të mundësuar realizimin e tyre në të ardhmen (<i>Evidenca Nr. 1.20, UNYT Individual Performance Assessment</i>). Ky plan veprimi përdoret në vitet në vijim edhe bëhet pjesë e objektivave që duhet të përmbushin pedagogët apo departamentet (<i>Takim me Stafin Akademik të Programit</i>).</p> <p>Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces sa me gjithëpërfshirës për të promovuar praktikën pozitive (<i>Evidenca Nr. 1.10, Rregullore e Programit MA në Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Përfshirja e sugjerimeve të studentëve me anketimet e përgatitura 2-3 herë në vit, kontributi i Unionit Studentor, si edhe komunikimi i vazhdueshëm i studentëve me pedagogët krijojnë mundësinë e përfshirjes së pritshmërive në objektivat e të ardhmes (<i>Evidenca Nr. 4.29, UNYT Senate Decision nr. 67020 on Staff Promotion</i>).</p> <p>Kjo praktikë bashkërendohet me vlerësimet e pedagogëve sic u përmend më lart dhe duke promovuar pedagogët të cilët arrijnë rezultate të larta si edhe duke ofruar cmimin “Profesori me i Mire i Vitit” për të stimuluar më tej arritjen e rezultateve sa më të larta (<i>Takim me Stafin Akademik të Programit</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet</p>	<p>UNYT përdor një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si p.sh. vlerësimet e studentëve falë anketave, apo vlerësimet e kolegëve që synojnë evidentimin e aspekteve për tu përmirësuar dhe pikave të forta (<i>Evidenca Nr. 6.4, Peer Evaluation Form</i>).</p> <p>Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të sillabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës (<i>Evidenca Nr. 6.6, Annual Monitoring Report Form</i>).</p> <p>Integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikën mbështetëse për studentët krijojnë mundësinë e pasjes së disa strukturave në dispozicion të këtij objekti si janë për shembull Këshilltari Akademik, Qendra e</p>

e rregulluara dhe të tjera.	Matematikës, Qendra e Shkrimit, Qendra e Mbështetjes, Zyra e Pranimit të Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Alumnit etj (<i>Evidenca Nr. 6.9.1, Student Evaluation report; Evidenca Nr. 6.8, UNYT Internal Audit Procedure Form</i>).			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Të gjitha grupet e interesuara sic janë studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ përdorin të gjitha instrumentat e lartëpërmendura për të bërë vlerësimin e performances së programeve të studimit duke bërë të mundur edhe arritjen e dy objektivave strategjikë: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve; b) përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të programeve (<i>Evidenca Nr.6.2, UNYT Annual Report NjsBC</i>). Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti (<i>Evidenca Nr. 5.14.2, List of Companies Participating in the Career Fair</i>). Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairin e Punës i cili organizohet në mënyrë periodike në muajin Maj nga UNYT (<i>Evidenca Nr. 5.14.5, Job Fair Main Poster Social Media</i>). Studentët e UNYT kanë marrë pjesë edhe në sondazhin kombëtar të organizuar nga ASCAL në vitin 2022, për matjen e kënaqshmërisë së studentëve në lidhje me cilësinë e arsimit të lartë (<i>Evidenca Nr. 6.15, UNYT ASCAL National Student Survey</i>).			
Konkluzione	<i>UNYT monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike përmes KPSSC dhe NjsBC cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit dhe kapaciteteve profesionale të studentëve për të qenë sa më të përgatitur për nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të	Sic u theksua më lart, strukturat e ngritura dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 64

<p>jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>programeve të studimit” (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UNYT</i>).</p> <p>KPSSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksinuara në Manualin e Cilësisë (<i>Evidenca Nr. 6.1</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KPSSC dhe NJSBC kanë hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.1, UNYT Quality Manual</i>). Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 në nenin 103 dhe 104, në Nenin 32 dhe 33 të Statutit të UNYT, si edhe në Manualin e KoGaSC. Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet edhe rregullorja e NJSBC (<i>Evidenca Nr. 6.3, Regulation of Permanent Quality Assurance and Standards Committee</i>). Me këto struktura dhe procedurave integrohet edhe plani i veprimit i hartuar nga KPSSC dhe NJSBC për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Brodi i Akreditimit për çdo program studimi, në të cilën përcaktohen detyrat për çdo strukturë të UNYT.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KPSSC dhe NJSBC së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për ceshtjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset aktivitet dhe veprimtaritë si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmave të përmendura më lart (<i>Evidenca Nr. 6.3, Regulation of the Permanent Quality Assurance & Standards Committee</i>).</p> <p>Njësia bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe në bashkëpunim me organet përkatëse të sigurimit të cilësisë bën të mundur analizimin e të dhënave të marra – falë bashkëpunimit me zyrat administrative - dhe përgatitjen e hapave të caktuar për përmirësimin e problemeve të vërejtura dhe përgjithësimin e praktikave pozitive (<i>Evidenca Nr. 6.2, UNYT Annual Report NJSBC 2021-2022</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KPSSC zgjidhet nga Senati Akademik me 6 anëtarë dhe përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe unionin studentor me një afat 2-vjeçar. (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UNYT</i>).</p> <p>Për të shmangur pabarazinë ose diskriminimin ndaj personelit dhe studentëve, UNYT ka hartuar Kodin e Etikës bazuar në legjislacionin përkatës si të administratës publike ashtu edhe Ministrisë së Arsimit (<i>Evidenca Nr. 4.7, UNYT Code of Ethic</i>).</p> <p>Anëtarët e këtyre organeve përzgjidhen nga stafi akademik me eksperiencë dhe me integritet për të shmangur çdo lloj pabarazie në trajtimin e studentëve apo pedagogëve (<i>Evidenca Nr. 6.3, Regulation of</i></p>

	<i>the Permanent Quality Assurance and Standards Committee).</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Si partner i projektit Erasmus + QainAl “Mbështetje Strategjike për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri” UNYT ka përfituar në përmirësimin e praktikave, procedurave dhe ekspertizës në përmirësimin e monitorimit të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 1.15, EUA Membership Activation</i>).</p> <p>Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, UNYT angazhon edhe partnerët strategjikë të institucionit apo Alumni përmes zyrës së karrierës në hartimin apo rishikimin e kurrikulave (<i>Evidenca Nr. 6.2, UNYT Annual Report of NjSBC 2021-2022</i>). Kjo bëhet për të kuptuar më mirë nevojat e tregut të punës dhe që sugjerimet e mbledhura të integrohen në kurrikulat mësimore (<i>Takim me Zyrën e Alumni</i>).</p>			
Konkluzione	<p><i>UNYT përfshin: a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik nëpërmjet P2P revieë; c) dhe studentët në nëpërmjet anketave dhe mekanizmit të ankimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit. Në rrethet e evidentimit të problemeve apo praktikave pozitive krijohet mundësia që nëpërmjet formave të njësuara sic janë raportet apo edhe takimet tematike të informojë palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe të kërkojë përpilimin e masave nëpërmjet departamentit si edhe zbatimin e tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin dhe rregulloren e Institucionit (<i>Evidenca Nr. 1.7, UNYT Rules and Regulations</i>).</p> <p>Ndërkohë që informacioni lidhur me këto akte ligjore publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen e internetit të institucionit. Po kështu publikohen edhe rregullorja e njësisë, KPSSC, dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe	UNYT publikon në faqen zyrtare të universitetit të gjitha vlerësimet e programeve të studimit për akreditimin institucional dhe vendos në dispozicion të publikut të gjitha vlerësimet nga ASCAL.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë
Tel: +355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al
Faqe 66

etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike, ndërsa konkluzionet dhe komentet u bëhen me dijë pedagogëve përkatës pasi ka përfunduar lënda për të ruajtur konfidencialitetin (<i>Evidenca Nr. 6.9.1, Student Survey Evaluation Report</i>).			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, Rektorati i kërkon Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve që të hartojnë projekt-buxhetet e tyre me zërat përkatës duke përfshirë nevojat akademike dhe aktivitetet e departamenteve që synojnë rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Ky projekt buxhet miratohet nga Senati Akademik dhe më pas nga Bordi i Administrimit (<i>Evidenca Nr. 4.31, Budget Plan</i>).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të IAL me KPSSC dhe NjsBC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca Nr. 6.6, UNYT Annual Monitoring Report Form</i>). KPSSC dhe NjsBC hartojnë një raport vjetor ku përfshihen veprimtaritë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. (<i>Evidenca Nr. 6.2, UNYT Annual Report of NjsBC 2021-2022.</i>).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies UNYT zbaton aktivitete të ndryshme si për shembull vizitat e ekspertëve të huaj akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, kërkimin e mënyrave për të përmirësuar ambientet në dispozicion që ato të mund të jenë sa më pranë nevojave të studentit dhe lëndëve përkatëse (<i>Evidenca Nr. 2.12, UNYT Research Pillars</i>).			
Konkluzione	<i>Prioritetet e vendosura, politikat, proceset e zbatuara, kriteret e përdorura dhe veprimtaritë e zhvilluara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente për të bërë sa më efektive implementimin e tyre, duke synuar krijimin e një kulture institucionale për arritjen e cilësisë dhe përmirësimin e proceseve për monitorimin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave
në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti i New York-ut Tiranë”**

Pika të forta dhe afirmime:



1. Institucioni ka një praktikë të mirë në angazhimin e studentëve në aktivitete shkencore siç është garantimi i pikëve shtesë për studentët që kryejnë punë kërkimore apo marrin pjesë në aktivitete shkencore.
2. Një numër i lartë pedagogësh që kontribuojnë në modulet e programit janë të arsimuar apo specializuar jashtë vendit dhe ndërmarrin aktivitete për kërkim shkencor cilësor të botuar në revista të njohura në fushat kërkimore të programit.
3. Programi ofrohet në gjuhën angleze, çfarë krijon më shumë mundësi për ndërkombëtarizimin e programit falë mundësisë së krijuar për ardhjen e studentëve dhe pedagogëve të huaj.
4. IAL ka një sistem transparent për vlerësimin e pedagogëve si nga ana e studentëve në aspektin e mësimdhënies, ashtu edhe në bazë të publikimeve për të matur nivelin e kërkimit shkencor.
5. Institucioni ka një infrastrukturë institucionale të mirëorganizuar dhe mbështetje financiare për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve.

Pika të dobëta:

1. Mungesa në kurrikulë e praktikës profesionale. **(Standardi I.3, Kriteri 3)**
2. Numri i studentëve është pak i qëndrueshëm dhe më i ulët në krahasim me programet e tjera të ofruara nga institucioni, gjë e cila mund të ndikojë në vijimësinë e këtij programi studimi.

Rekomandime:

1. GVJ sugjeron që institucioni të realizojë përmirësime në kurrikulë ku të përfshihet “Praktika Profesionale”, si një domosdoshmëri për ti mundësuar studentit lidhjen me tregun e punës përmes kontaktit që vendoset nga zhvillimi i praktikës profesionale. **(Standardi I.3, Kriteri 3)**
2. GVJ sugjeron që njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi të hartojë në vijim raport analitik të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. **(Standardi I.3, Kriteri 4)**
3. GVJ sugjeron një format të unifikuar për të gjitha syllabuset **(Standardi II.4, Kriteri 5)**



4. GVJ sugjeron që nisma për krijimin e grupeve kërkimore të bëhet në vijim pjesë e rregullores së departamentit (**Standardi II.7, Kriteri 1**)

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in
"International Relations" provided by the Higher Education Institution University of
New York in Tirana**

Strengths and affirmations:


1. The institution has established a positive experience by engaging students in scientific activities and granting for that participation additional points in the final exam.
2. A considerable number of teachers contributing to preparing/implementing the academic program are specialized abroad and undertake qualitative research in scientific journals operating in pertinent areas for the program.
3. The delivery of academic programs in English contributes to the process of internationalization thanks to more opportunities for exchanging students and lecturers.
4. The IAL has in place a transparent process of evaluating the lecturers thanks to students in terms of teaching capacities, other colleagues in terms of teaching and research results as well as the quality/quantity of research publications.
5. The institution has a well-organized institutional infrastructure to offer financial support for students' mobility.

Weaknesses:


1. Lack of professional practice in the curriculum. (**Standard I. 3, Criterion 3**)
2. The number of students is a little stable and lower compared to other programs offered by the institution, which may affect the continuity of this study program.

Recommendations:

1. The External Evaluation Team suggests to the institutions to include the internship in the curricular program. This is necessary to enable the students to start establishing contacts during the internship. (**Standard I.3, Criterion 3**).



2. EET suggests to the department in charge of this study program to start producing a report to analyze the benefits of the program from the current collaboration agreements. **(Standard I.3, Criterion 4).**
3. EET suggests a unique format for all the syllabuses **(Standard II.4, Criterion 5).**
4. It is suggested that the initiative to establish the research groups can be integrated into the regulation of the department **(Standard II.7, Criterion 1).**



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

